

PROGRAMIT I PËBASHKËT I PEDAGOGJISË,
PJESA E PARË

BLLOKU I KURRIKULËS

Pyetja 1

Cila është metoda më e vjetër e kurrikulës:

- A) Metoda biheviriste
- B) Metoda humaniste
- C) Metoda menaxheriale
- D) Metoda akademike

Pyetja 2

Cila nga metodat e mëposhtme vazhdon të jetë ende metoda kryesore e kurrikulës:

- A) Metoda humaniste
- B) Metoda menaxheriale
- C) Metoda biheviriste
- D) Metoda akademike

Pyetja 3

Cilës nga metodat e mëposhtme i përket këto karakteristika?

“Është metodë e drejtimit mjet-qëllim. Mbështetet në parime teknike e shkencore. Synimet dhe objektivat e saj janë të konkretizuara, përmbajtja dhe veprimtaritë renditen për t’iu përgjigjur objektivave, kurse rezultatet e të mësuarit vlerësohen në lidhje me synimet dhe objektivat”.

- A) Metodës humaniste
- B) Metodës biheviriste
- C) Metodës menaxheriale
- D) Metodës akademike

Pyetja 4

Cilës nga metodat e mëposhtme i përket këto karakteristika?

“Kjo metodë e merr shkollën si sistem shoqëror, çka të kujton teorinë organizative. Arsimitarët që mbështeten në këtë metodë, e planifikojnë kurrikulën në drejtim të programeve, orareve, hapësirës, burimeve, pajisjeve dhe personelit. Vëmendje u kushtohet proceseve në komitet dhe në grup, marrëdhëniet njerëzore, stilet dhe metodave të drejtimit, si dhe vendim-marrjes”.

- A) Metodës humaniste
- B) Metodës biheviriste
- C) Metodës menaxheriale
- D) Metodës akademike

Pyetja 5

Cilës nga metodat e mëposhtme i përkasin këto karakteristika?

“Ndonjëherë e quajtur me emrin inxhinieri kurrikulare, kjo metodë përfshin proceset e domosdoshme të planifikimit të kurrikulës nga inxhinierë të tillë si inspektorët, drejtorët dhe bashkërenduesit: fazat (zhvillimi, hartimi, zbatimi dhe vlerësimi) dhe strukturat (lëndët, kurset, planet e njëjësive dhe planet e orëve të mësimit)”.

- A) Metodës humaniste
- B) Metodës biheviriste
- C) Metodës së sistemeve
- D) Metodës akademike

Pyetja 6

Cilën nga teoritë e mëposhtme Xhorxh Boshamp e ndau në pesë teori të mëdha me rëndësi të barabartë si: (1) administrimi, (2) këshillimi, (3) kurrikula, (4) mësimdhënia dhe (5) vlerësimi.

- A) Teorinë humaniste
- B) Teorinë e sistemeve
- C) Teorinë biheviriste
- D) Teorinë rikonceptualiste

Pyetja 7

Cilës nga metodat e mëposhtme i përkasin këto karakteristika?

“Ndonjëherë e quajtur edhe si metoda tradicionale, enciklopedike, parashikuese, intelektuale ose e orientuar nga njohja. Kjo metodë priret drejt natyrës historike ose filozofike dhe më pak sociale. Diskutimi për modelin e kurrikulës zakonisht është akademik dhe teorik dhe merret me shumë aspekte të gjera të shkollimit, përfshirë studimin e arsimit”.

- A) Metodës humaniste
- B) Metodës biheviriste
- C) Metodës së sistemeve
- D) Metodës akademike

Pyetja 8

Cilës nga metodat e mëposhtme i përkasin këto karakteristika?

“Nga kjo metodë kanë lindur një sërë veprimtarish për kurrikulat, kryesisht në arsimin tetëvjeçar, përfshirë mësimet e mbështetura në përvojat jetësore, lojërat në grupe, projektet në grupe, veprimtaritë artistike, dramatizimin, udhëtimet në terren”.

- A) Metodës humaniste
- B) Metodës biheviriste
- C) Metodës së sistemeve
- D) Metodës akademike

Pyetja 9

Cilës nga metodat e mëposhtme i përkasin këto karakteristika?

“Është e përqëndruar në çështjet më të mëdha ideologjike dhe morale të arsimit dhe edukimit (jo vetëm të kurrikulës) dhe përpiqen të hulumtojnë, madje edhe të ndikojnë në institucionet ekonomike dhe politike të shoqërisë. Përqëndrohen më shumë tek të kuptuarit e kurrikulës se sa tek zhvillimi i saj”.

- A) Metodës humaniste
- B) Metodës biheviriste
- C) Metodës rikonceptualiste
- D) Metodës akademike

Pyetja 10

Plani mësimor përmban:

- A) Sasinë javore të orëve mësimore për çdo klasë dhe lëndë.
- B) Listën e lëndëve dhe sasinë javore të orëve mësimore për çdo klasë.
- C) Listën e lëndëve dhe sasinë javore të orëve mësimore për çdo lëndë.
- D) Listën e lëndëve dhe sasinë javore të orëve mësimore për çdo klasë dhe për çdo lëndë

Pyetja 11

Plani mësimor përmban:

- A) Listën e lëndëve dhe sasinë javore të orëve mësimore për çdo klasë dhe për çdo lëndë.
- B) Listën e lëndëve dhe sasinë mujore të orëve mësimore për çdo klasë dhe për çdo lëndë

- C) Listën e lëndëve dhe sasinë semestrale të orëve mësimore për çdo klasë dhe për çdo lëndë
- D) Listën e lëndëve dhe sasinë vjetore të orëve mësimore për çdo klasë dhe për çdo lëndë

Pyetja 12

Kush e harton Planin mësimor?

- A) Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
- B) Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra arsimore
- C) Drejtoria e shkollës
- D) Vetë mësuesi

Pyetja 13

Kush e harton programin mësimor të lëndëve përkatëse të shkollave të arsimit bazë?

- A) Vetë mësuesi
- B) Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
- C) Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra arsimore
- D) Drejtoria e shkollës

Pyetja 14

Kush e harton programin mësimor të lëndëve përkatëse të shkollave të arsimit të mesëm të lartë?

- A) Drejtoria e shkollës
- B) Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra arsimore
- C) Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
- D) Vetë mësuesi

Pyetja 15

Kush e harton planifikim ditor të punës së mësuesit?

- A) Drejtoria e shkollës
- B) Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra arsimore
- C) Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
- D) Vetë mësuesi

Pyetja 16

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë?

- A) Metoda tekniko-shkencore në kurrikul është mënyrë planifikimi e kurrikulës, për të arritur maksimumin e të mësuarit të nxënësve dhe për të rritur ndikimin e tyre.
- B) Metoda tekniko-shkencore në kurrikul e vë theksin në subjektiven, vetjaken, estetikën, heuristikën dhe transaksionalen.
- C) Metoda tekniko-shkencore në kurrikul u kushton vëmendje jo aq rezultateve të prodhimit se sa nxënësit, sidomos nëpërmjet metodave mësimore të orientuara nga veprimtaria.
- D) Metoda tekniko-shkencore në kurrikul nënvizon se jo të gjitha qëllimet përfundimtare të arsimit mund të dihen, madje as nevojitet të dihen në çdo rast.

Pyetja 17

Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë?

- A) Metoda joteknike-joshkencore në kurrikul është mënyrë planifikimi e kurrikulës, për të arritur maksimumin e të mësuarit të nxënësve dhe për të rritur ndikimin e tyre.
- B) Metoda joteknike-joshkencore në kurrikul e vë theksin në subjektiven, vetjaken, estetikën, heuristikën dhe transaksionalen.
- C) Metoda joteknike-joshkencore në kurrikul shfrytëzon një paradigmë të llojit mjet-qëllim, e cila sugjeron që, sa më të rrepta mjetet, aq më e mundshme arritja e qëllimeve të dëshiruara.
- D) Sipas metodës joteknike-joshkencore zhvillimi i kurrikulës është një plan ose program për strukturimin e mjedisit të të mësuarit dhe për bashkërendimin e elementeve personeli, materiale dhe pajisje.

Pyetja 18

Ralf Tiler tregoi se planifikuesit e kurrikulës duhet t'i identifikojnë objektivat e përgjithshëm duke mbledhur të dhëna nga tre burime. Këto burime janë:

- A) Mësuesit, nxënësit dhe specialistët e kurrikulës,
- B) Mësuesit, nxënësit dhe drejtuesit e shkollës,
- C) Përmbajtja, nxënësit dhe shoqëria,
- D) Nxënësit, drejtuesit e shkollës dhe specialistët e kurrikulës.

Pyetja 19

Modelet e ndryshme tekniko-shkencore shfaqin atë që Xheims Mekdonald do ta quante:

- A) Racionalitet "estetik"
- B) Racionalitet "teknologjik"
- C) Racionalitet "artistik"
- D) Racionalitet "shkollor"

Pyetja 20

Racionalja e bazës ishte një model i zhvillimit të kurrikulës i hartuar nga:

- A) Ralf Tiler
- B) Hilda Taba
- C) Francis P. Hunkins
- D) Ronald Doll

Pyetja 21

Modeli i vendim-marrjes i hartimit të kurrikulës është hartuar nga:

- A) Ralf Tiler
- B) Hilda Taba
- C) Francis P. Hunkins
- D) Ronald Doll

Pyetja 22

Kush ishte përfaqësuesi i metodës tekniko-shkencore të zhvillimit të kurrikulës nga lart-poshtë, apo të quajtur ndryshe si modeli administrativ:

- A) Ralf Tiler
- B) Hilda Taba
- C) Francis P. Hunkins
- D) Ronald Doll

Pyetja 23

Kush ishte përfaqësuesi i metodës tekniko-shkencore të zhvillimit të kurrikulës nga poshtë- lart, apo të quajtur ndryshe si metoda e bazës:

- A) Ralf Tiler
- B) Hilda Taba
- C) Francis P. Hunkins
- D) Ronald Doll

Pyetja 24

Hilda Taba përshkroi etapat në modelin e saj të bazës, ku rolin kryesor do ta luanin:

- A) Politikëbërësit
- B) Specialistët e kurrikulës
- C) Drejtuesit e shkollave
- D) Mësuesit

Pyetja 25

Qarko cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë.

- A) Heuristika është metodë mësimore që i ndihmon nxënësit e studentët të mësojnë duke i zbuluar gjërat vetë dhe të mësojnë më tepër nga përvojat e tyre se sa duke u treguar mësuesi për to.
- B) Heuristika është metodë mësimore që përdoret në kuptimin e një veprimi ose veprimtarie komunikimi ndërmjet dy palëve që ndikojnë tek njëra-tjetra në mënyrë të ndërsjellë.
- C) Heuristika është metodë mësimore sipas së cilës nxënësit mësojnë duke u mbështetur te puna e pavarur e tyre.
- D) Heuristika është metodë mësimore sipas së cilës nxënësit mësojnë duke u mbështetur te shpjegimi cilësor i mësuesit.

Pyetja 26

Kush ishte përfaqësuesi i modeli natyralist, apo të quajtur ndryshe si qëndrimi i mesëm, për zhvillimin e kurrikulës:

- A) Ralf Tiler
- B) Hilda Taba
- C) Allan Glatthornit
- D) Francis P. Hunkins

Pyetja 27

Cila nga pohimet e mëposhtme i përket metodës teknike-shkencore?

- A) Zhvillimi i kurrikulës është një proces dinamik, plot me pasiguri
- B) Zhvillimi i kurrikulës është “bisedë e specializuar”
- C) Zhvillimi i kurrikulës është subjektiv, individual, estetik, transaksional
- D) Zhvillimi i kurrikulës përfshin vendimet kryesore, është racional

Pyetja 28

Cila nga pohimet e mëposhtme i përket metodës joteknike?

- A) Fazat kryesore mund të identifkohen, të administrohen
- B) Zhvillimi i kurrikulës është një proces dinamik, plot me pasiguri
- C) Zhvillimi i kurrikulës përfshin vendimet kryesore, është racional
- D) Zhvillimi i kurrikulës ka shkallë të lartë objektiviteti, logjike

Pyetja 29

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk i përket kritereve për zgjedhjen e përmbajtjes së kurrikulës?

- A) Rëndësia
- B) Vërtetësia
- C) Sasia
- D) Interesi

Pyetja 30

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk i përket kritereve për zgjedhjen e përmbajtjes së kurrikulës?

- A) Dobia
- B) Vetë-mjaftueshmëria
- C) Përvetësueshmëria
- D) Vështirësia

Pyetja 31

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk i përket komponentëve të hartimit të kurrikulës të autorit Henri Xhails (Henri Xhails trajton natyrën dhe organizimin e pjesëve themelore të kurrikulës)?

- A) Planifikimi
- B) Përmbajtja
- C) Metoda dhe organizimi
- D) Vlerësimi

Pyetja 32

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk i përket komponentëve të kurrikulës të autorit Henri Xhails (Henri Xhails trajton natyrën dhe organizimin e katër pjesëve themelore të kurrikulës)?

- A) Përmbajtja

- B) Metoda dhe organizimi
- C) Vlerësimi
- D) Rivlerësimi

Pyetja 33

Cili nga shembujt e mëposhtëm i përket organizimit horizontal të kurrikulës?

- A) Vendosja e “familjes” në studimet sociale për klasën e parë, dhe e “komunitetit” në studimet sociale për klasën e dytë
- B) Koncepti i bashkësisë prezantohet në klasën e parë dhe rimerret ose përmendet në çdo vit pasardhës në kurrikulën e arsimit nëntëvjeçar
- C) Marrja e përmbajtjes nga matematika (Psh. formulave të matematike) dhe përfshirja e saj në lëndën e fizikës (në zgjidhjen e problemave të fizikës)
- D) Marrja e njohurive fillestare mbi drejtshkrimin në klasën e parë dhe thellimi i tyre në klasat pasardhëse.

Pyetja 34

Cili nga shembujt e mëposhtëm i përket organizimit vertikal të kurrikulës?

- A) Marrja e koncepteve në gjuhës shqipe dhe përdorimi i tyre për mësimin e koncepteve të gjuhës angleze
- B) Koncepti i bashkësisë prezantohet në klasën e parë dhe rimerret ose përmendet në çdo vit pasardhës në kurrikulën e arsimit nëntëvjeçar
- C) Marrja e përmbajtjes nga matematika (Psh. formulave të matematike) dhe përfshirja e saj në lëndën e fizikës (në zgjidhjen e problemave të fizikës)
- D) Marrja e përmbajtjes nga fizika dhe përfshirja e saj në lëndën e kimisë

Pyetja 35

Cilit nga aspektet e hartimit të kurrikulës i përket pohimi: “Të mësuarit nga e thjeshta te e ndërlikuara”?

- A) Shtrirja
- B) Renditja
- C) Vazhdimësia
- D) Integrimi

Pyetja 36

Cilit nga aspektet e hartimit të kurrikulës i përket pohimi: “Të mësuarit sipas përdorimit”?

- A) Shtrirja
- B) Renditja
- C) Vazhdimësia

D) Integrimi

Pyetja 37

Cilit nga aspektet e hartimit të kurrikulës i përket pohimi: “Kurrikula e përqëndruar tek fëmija dhe tek lënda”?

- A) Shtrirja
- B) Renditja
- C) Vazhdimësia
- D) Baraspesha

Pyetja 38

Cilit nga alternativat e mëposhtme, të prezantuara nga Smith, Stenli dhe Shors, nuk i përket parimeve të të mësuarit,?

- A) Të mësuarit nga më e thjeshta në më të ndërlikuarën
- B) Të mësuarit sipas përdorimit
- C) Të mësuarit e së tërës dhe pastaj të mësuarit e pjesëve
- D) Të mësuarit kronologjik

Pyetja 39

Cilit nga alternativat e mëposhtme, të prezantuara nga Posner dhe Straik, nuk i përket organizuesve si përcaktues të renditjes?

- A) Të mësuarit sipas konceptit
- B) Të mësuarit sipas përdorimit
- C) Të mësuarit sipas hulumtimit
- D) Të mësuarit e së tërës dhe pastaj të mësuarit e pjesëve

Pyetja 40

Cilit nga alternativat e mëposhtme, nuk i përket vazhdimësisë si aspekt i hartimit të kurrikulës?

- A) Një ndër tiparet kryesore të hartimit të kurrikulës është të përafrojë të gjitha pjesët e kurrikulës në mënyra që e aftësojnë individin ta kuptojë dijen më mirë si të njësuar se sa të copëzuar, si dhe lidhjen e të gjitha llojeve të njohurive dhe të përvojave në planin e kurrikulës
- B) Kurrikula duhet të organizohet sipas lidhjeve të ndërsjella ndërmjet strukturës së ideve themelore të çdo disipline kryesore. Që nxënësi t'i përvetësojë këto struktura dhe ide themelore, “ato duhen zhvilluar dhe ri zhvilluar sipas një modeli spiral” – me thellësi dhe gjerësi në rritje, në raport me përshkallëzimin e programit.

- C) Është e sigurt se nxënësit do të kenë raste të ripërdorin shprehi dhe koncepte themelore sa herë të jetë e nevojshme.
- D) Përsëritjen ose përdorimin vertikal të përbërësve të kurrikulës, si dhe rishfaqjen në kurrikul të shprehive ose ideve të caktuara kryesore.

Pyetja 41

Cila nga alternativat e mëposhtme, nuk i përket modeleve përfaqësuese të kurrikulës?

- A) Modelet e përqendruara tek lënda
- B) Modelet e përqendruara tek nxënësi
- C) Modelet e përqendruara tek përvoja e mësuesve
- D) Modelet e përqendruara tek problemi

Pyetja 42

Cila nga alternativat e mëposhtme, nuk i përket modeleve përfaqësuese të kurrikulës të përqendruar tek nxënësi?

- A) Modele të përqendruara te fëmija
- B) Modelet e lëndës
- C) Modele të përvojës
- D) Modelet humaniste

Pyetja 43

Cila nga alternativat e mëposhtme, nuk i përket modeleve përfaqësuese të kurrikulës të përqendruar tek problemi?

- A) Modeli i situatave jetësore
- B) Modeli bërthamë
- C) Modeli i disiplinës
- D) Modeli i problemeve sociale/rikonstruksioniste

Pyetja 44

Cilit model të modelit të përqendruar te lënda i përket pohimi i mëposhtëm?

“Është modeli më i vjetër dhe më i njohur si nga mësuesit ashtu dhe nga njerëzit e zakonshëm. Ai njihet kaq mirë, sepse tradicionalisht mësuesit dhe njerëzit e zakonshëm janë arsimuar dhe/ose janë formuar në shkollat që e kanë përdorur atë”

- A) Modeli i lëndës
- B) Modeli i disiplinës,
- C) Modeli i fushave të gjera

D) Modeli i procesit

Pyetja 45

Cilit model të modelit të përqendruar të lëndës i përket pohimi i mëposhtëm?

“Modelet kurrikulare duhet të trajtojnë mënyrën si të mësojnë nxënësit”.

- A) Modeli i lëndës
- B) Modeli i disiplinës
- C) Modeli i fushave të gjera
- D) Modeli i procesit

Pyetja 46

Cilit model të modelit të përqendruar të nxënësi i përket pohimi i mëposhtëm?

“Hajnrih Pestalozi dhe Fridrih Frwbel argumentuan se fëmijët do ta arrinin vetë-realizimin nëpërmjet pjesëmarrjes në shoqëri; ata parashtruan parimin e të mësuarit duke bërë”.

- A) Modele të përqendruara të fëmija
- B) Modele të përvojës
- C) Modele radikale
- D) Modele humaniste

Pyetja 47

Cilit model të modelit të përqendruar të nxënësi i përket pohimi i mëposhtëm?

“Shkollat i kanë përdorur kurrikulat e tyre më tepër për të kontrolluar dhe për të indoktrinuuar individët që të pranojnë një pikëpamje të caktuar kulturore, se sa për t’i arsimuar dhe emancipuar ata”.

- A) Modele të përqendruara të fëmija
- B) Modele të përvojës,
- C) Modele radikale
- D) Modele humaniste

Pyetja 48

Cilit model të modelit të përqendruar të nxënësi i përket pohimi i mëposhtëm?

“Ky orientim i ri psikologjik theksoi se veprimi njerëzor ishte shumë më tepër se reagim ndaj një ngacmimi; kuptimi ishte më i rëndësishëm se metoda. Prandaj epiqendra e vëmendjes duhej të ishte më tepër në natyrën subjektive se sa në atë objektive të ekzistencës njerëzore. Ide tjetër ishte se ndërmjet të mësuarit dhe ndjenjës ka një lidhje”.

- A) Modele të përqendruara të fëmija

- B) Modele të përvojës,
- C) Modele radikale
- D) Modele humaniste

Pyetja 49

Cilit model i përket pohimi i mëposhtëm?

“Kurrikula e Herbert Spenserit e vinte theksin në veprimtari që zgjasin jetën, lartësojnë jetën, ndihmojnë në rritjen e fëmijëve, etj....”.

- A) Modele të situatave jetësore
- B) Modele bërthamë
- C) Modele të problemeve sociale/rikonstruksioniste
- D) Modele radikale

Pyetja 50

Cilit model i përket pohimi i mëposhtëm?

“Xhorxh Kaunts besonte se shoqëria duhej riorganizuar tërësisht, për të realizuar të mirën e përbashkët. Kohët kërkonin një rend të ri shoqëror dhe shkollat duhej të luanin një rol madhor në këtë rimodelim”.

- A) Modele të situatave jetësore
- B) Modele bërthamë
- C) Modele të problemeve sociale/rikonstruksioniste
- D) Modele radikale

Pyetja 51

Cila nga kategoritë e mëposhtme nuk i përket lëmit njohës? (Objektivat janë të klasifikuara në objektiva të lëmit njohës, lëmit emotiv dhe lëmit psikomotor. Çdo lëmë është i ndarë në kategori).

- A) Njohja
- B) Të kuptuarit
- C) Zbatimi
- D) Reagimi

Pyetja 52

Cila nga kategoritë e mëposhtme nuk i përket lëmit njohës? (Objektivat janë të klasifikuara në objektiva të lëmit njohës, lëmit emotiv dhe lëmit psikomotor. Çdo lëmë është i ndarë në kategori).

- A) Analiza
- B) Sinteza
- C) Organizimi
- D) Vlerësimi

Pyetja 53

Cila nga kategoritë e mëposhtme nuk i përket lëmit emotiv? (Objektivat janë të klasifikuara në objektiva të lëmit njohës, lëmit emotiv dhe lëmit psikomotor. Çdo lëmë është i ndarë në kategori).

- A) Pranueshmëria
- B) Sinteza
- C) Reagimi
- D) Organizimi

Pyetja 54

Cila nga kategoritë e mëposhtme nuk i përket lëmit emotiv? (Objektivat janë të klasifikuara në objektiva të lëmit njohës, lëmit emotiv dhe lëmit psikomotor. Çdo lëmë është i ndarë në kategori).

- A) Pranueshmëria
- B) Organizimi
- C) Analiza
- D) Karakterizimi

Pyetja 55

Cila nga kategoritë e mëposhtme nuk i përket lëmit psikomotor? (Objektivat janë të klasifikuara në objektiva të lëmit njohës, lëmit emotiv dhe lëmit psikomotor. Çdo lëmë është i ndarë në kategori).

- A) Reagimi
- B) Lëvizjet refleksive
- C) Lëvizjet themelore
- D) Aftësitë perceptive

Pyetja 56

Cila nga kategoritë e mëposhtme nuk i përket lëmit psikomotor? (Objektivat janë të klasifikuara në objektiva të lëmit njohës, lëmit emotiv dhe lëmit psikomotor. Çdo lëmë është i ndarë në kategori).

- A) Aftësitë fizike
- B) Lëvizjet e kualifikuara
- C) Komunikimi i vijueshëm
- D) Të kuptuarit

Pyetja 57

Sa herë që hartohet një program i ri, kanalet e komunikimit duhet të mbahen të hapura. Komunikimi ndodh në nivele të ndryshme. Cili nga nivelet e komunikimit mendohet se do të jetë drejtimi i së ardhmes?

- A) Komunikimi nga lart poshtë
- B) Komunikimi nga poshtë lart
- C) Komunikimi anësor
- D) Komunikimi zyrtar

Pyetja 58

Me qëllim që planifikimi i kurrikulës të realizohet (sipas Metju Maills dhe Karen Luis) në leksikon e administrimit, vetëm kohët e fundit po flitet shumë për:

- A) Qëllime
- B) Synime
- C) Vizion
- D) Objektiva

Pyetja 59

Cilido qoftë orientimi ndaj kurrikulës, nuk mohohet që zbatimi dhe/ose realizimi kërkojnë planifikim dhe planifikimi përqëndrohet në tre faktorë. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk i përket këtyre tre faktorëve?

- A) Njerëzit
- B) Programet
- C) Proceset
- D) Financat

Pyetja 60

Që ndryshimi në kurrikul të realizohet me sukses, duhet të zbatohen pesë udhëzime, të cilat ndihmojnë në shmangien e gabimeve. Në prej udhëzimeve është risia. Cila nga alternativat e mëposhtme është e saktë?

- A) Risia duhet të jetë e administrueshme dhe e realizueshme nga ideatorët e risisë
- B) Risia duhet të jetë e administrueshme dhe e realizueshme nga mësuesi i nivelit fillestar
- C) Risia duhet të jetë e administrueshme dhe e realizueshme nga mësuesi i nivelit mesatar
- D) Risia duhet të jetë e administrueshme dhe e realizueshme nga mësuesi i nivelit të lartë

**PROGRAMIT PEDAGOGJISË,
PJESA E DYTË
“METODAT E MËSIMDHËNIES DHE MENDIMI KRITIK”**

Pyetja 1

Tipari dallues dhe mbizotërues i mësimdhënies, si veprimtari e organizuar, është procesi i:

- A) Organizimit
- B) Planifikimit
- C) Menaxhimit
- D) Koordinimit

Pyetja 2

Fjalët mësimdhënie dhe e nxënë, paraqesin dy:

- A) Veprimtari të ndryshme të procesit të mësimdhënies
- B) Veprimtari të njëjta të procesit të mësimdhënies
- C) Veprimtari të njëjta që kanë shumë lidhje me njëra-tjetrën
- D) Veprimtari të ndryshme që kanë shumë lidhje me njëra-tjetrën

Pyetja 3

Njohuritë për qëllimet dhe objektivat mësimore, për nxënësin dhe lëndën si edhe për metodat mësimore, i duhen mësuesit për të qënë një:

- A) Organizator i mirë
- B) Lider i suksesshëm
- C) Menaxher i aftë
- D) Vendimmarrës i drejtë

Pyetja 4

Një lloj veprimtarie, e cila nuk merret në konsideratë nga ana e mësuesit për planifikimin e mësimit, është edhe:

- A) Përcaktimi i qëllimeve të mësimit
- B) Problematika e konsultimit të nxënësve
- C) Përcaktimi i nevojave të nxënësve
- D) Përzgjedhja e përmbajtjes së materialit të ri

Pyetja 5

Aktivitete të tilla si: tërheqja e vëmendjes, komunikimi i objektivave, aktivizimi i kujtesës dhe rikujtimi i njohurive të mëparshme, paraqitja e materialit, formimi i sjelljes së dëshirueshme, sigurimi i komenteve dhe informacionit si edhe vlerësimi i sjelljes, janë pjesë përbërëse të:

- A) Dosjes së shkollës
- B) Planit të klasës
- C) Planit ditari
- D) Programit lëndor

Pyetja 6

Një metodë mësimit, që kryhet me qëllim që nxënësit të njohin objektet, dukuritë, proceset dhe ngjarjet në mjedisin e tyre natyror, është edhe:

- A) Praktika
- B) Eksperimenti
- C) Demonstrimi
- D) Ekskursioni

Pyetja 7

Parashikimi i mësimit, që e ndihmon mësuesin të përzgjedhë që më parë mjetet mësimore, është funksion i:

- A) Planit të aktiviteteve të klasës
- B) Planit ditari të mësuesit
- C) Programit lëndor të lëndës
- D) Menaxhimit të klasës gjatë mësimit

Pyetja 8

Secila prej veprimtarive të të nxënësit që mësuesi përdor në klasë, gjatë një ore mësimi, duhet të synojë të paktën:

- A) Organizimin e nxënësve në klasë
- B) Zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të ulët.
- C) Zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë
- D) Një nga objektivat e mësimit

Pyetja 9

Në rastet kur mësimi nuk shkon siç duhet, diçka ngjet para ose pas mësimit ose nxënësit e kërkojnë vetë ndryshimin, mësuesi mund të:

- A) Ndryshojë metodat e mësimdhënies
- B) Tërheqë vëmendjen e nxënësve problematikë
- C) Merret vetëm me nxënësit problematikë
- D) Dalë jashtë kornizave të planit ditari

Pyetja 10

Vërtetësia, përzgjedhshmëria, llojshmëria e mësimit të ri janë pjesë e:

- A) Komunikimit të objektivave
- B) Tërheqjes së vëmendjes së nxënësve
- C) Paraqitjes së materialit të ri mësimor.
- D) Rikujtimi i njohurive të mëparshme

Pyetja 11

Mësuesi, përpara se të përdorë një mjet didaktik apo një mjet laboratorik për demonstrimin e mësimit, duhet:

- A) Ta provojë nëse funksionon përpara mësimit
- B) Ta vendosë në punë gjatë orës së mësimit
- C) Ta provojë dhe ta kontrollojë përpara mësimit
- D) Ta provojë, kontrollojë dhe ta provojë përsëri përpara mësimit.

Pyetja 12

Elementët, të tillë si: qëndrimi i mësuesit në klasë, problemi i kohës si edhe përgatitja e mjeteve dhe materialeve të tjera ndihmëse, janë:

- A) Elementët bazë të paraqitjes së materialit të ri mësimor
- B) Elementët e tërheqjes së vëmendjes së nxënësve
- C) Elementët ndihmëse në paraqitjen e materialit të ri mësimor
- D) Elementët e rikujtimit të informacionit

Pyetja 13

Mësuesi duhet të marrë parasysh natyrën e materialit mësimor, tipin e të nxënësve, nivelin dhe nevojat e nxënësve, gjëndjen bazë materiale didaktike të klasës/shkollës, përpara se të përzgjedhë:

- A) Veprimtaritë e të nxënësve
- B) Mjetet didaktike
- C) Mënyrën e testimit
- D) Objektivat mësimore

Pyetja 14

Procesi, ku gjatë orës së mësimi çdo nxënës duhet të vihet në një pozitë që të përfshihet në të nxënët provë-gabim, apo në ndonjë mënyrë tjetër duke bërë përmbledhje, perifrazime, zbatime dhe zgjidhje të problemit, ka të bëjë me:

- A) Procesin e rikujtimit të informacionit të ri.
- B) Aktivizimin e kujtesës nga ana e nxënësit
- C) Formimin e sjelljes së dëshiruar nga ana e nxënësit.
- D) Procedurat e mësimdhënies gjatë orës së mësimi

Pyetja 15

Mbajtja e shënimeve nga ana e mësuesit në klasë mbi ecurinë e nxënësve duhet të jetë:

- A) Sipas dëshirës së mësuesit
- B) Në varësi nga situata që krijohet në klasë
- C) Normë e detyrueshme e punës së mësuesve
- D) Vetëm kur nxënësit nuk kanë ecuri të mirë

Pyetja 16

Në vendimet që merr mësuesi për përcaktimin e metodave mësimore që do të përdoren gjatë orës së mësimi nuk mban parasysh:

- A) Nivelin e zhurmave në klasë
- B) Mënyrën e paraqitjes së materialit të ri
- C) Organizimin dhe menaxhimin e klasës
- D) Ritmin e materialit që do të mësohet

Pyetja 17

Sjellja e dëshirueshme gjatë procesit të të nxënët në klasë arrihet atëherë kur nxënësit:

- A) Arrijnë të kuptojnë saktësinë e përgjigjeve të tyre
- B) Komunikojnë mirë me mësuesin
- C) Komunikojnë mirë në grup me njëri-tjetrin
- D) Zgjidhin një detyrë që u ngarkohet

Pyetja 18

Aktivizimi i kujtesës, për të rikujtuar informacionin e mëparshëm, është kusht fillestar për:

- A) Përsëritje kapitulli
- B) Të nxënët e kuptimshëm
- C) Zgjidhjen e një situatë problemore
- D) Provimin përfundimtar

Pyetja 19

Veprimtaria bisedore e mësuesit, ku shpjegimi i mësimi nga ana e mësuesit zë rolin qendror gjatë orës së mësimi, është pjesë përbërëse e metodës së:

- A) Mësimdhënies së drejtëpërdrejtë
- B) Parashikimit me terma paraprakë
- C) Përmbledhjes Pohim-Mbështetje
- D) Mësimdhënies jo të drejtëpërdrejtë

Pyetja 20

Rezultatet e të nxënit të cilat klasifikohen si fakte, rregulla dhe veprime zbatuese paraqet një sjellje:

- A) Të nivelit të ulët dhe të mesëm të fushave njohëse, emocionale dhe psikomotore
- B) Të nivelit të ulët dhe të lartë të fushave njohëse, emocionale dhe psikomotore
- C) Të nivelit të ulët dhe të thjeshtë të fushave njohëse, emocionale dhe psikomotore
- D) Të nivelit të mesëm dhe të lartë të fushave njohëse, emocionale dhe psikomotore

Pyetja 21

Mësuesi zgjedh strategjitë e përshtatshme të mësimdhënies, për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë të nxënësit, për të:

- A) Realizuar një orë të suksesshme mësimi
- B) Arritur përfundimet e dëshiruara të të nxënit
- C) Menaxhuar si duhet klasën gjatë orës së mësimi
- D) Për të vënë rregullin në klasë përpara fillimit të mësimi

Pyetja 22

Rezultatet e të nxënit, të cilat klasifikohen si koncepte, modele dhe abstraksione, paraqesin një sjellje të nivelit:

- A) Të mesëm dhe të lartë të fushave njohëse, emocionale dhe psikomotore
- B) Të ulët dhe të mesëm të fushave njohëse, emocionale dhe psikomotore
- C) Të lartë dhe të ndërlikuar të fushave njohëse, emocionale dhe psikomotore
- D) Të ulët dhe të thjeshtë të fushave njohëse, emocionale dhe psikomotore

Pyetja 23

Të dhënat kërkimore, mbështesin idenë se qartësia e shpjegimit, që shpesh quhet edhe qartësia e mësuesit, jep një ndihmesë shumë të rëndësishme në:

- A) Arritjet e përgjithshme të nxënësve në atë lëndë
- B) Realizimin e suksesshëm të një ore mësimi
- C) Planifikimin e planit ditari për orën e mësimi
- D) Përthithjen e njohurive nga ana e nxënësve

Pyetja 24

Komunikimi i objektivave në fillim të orës së mësimi nga ana e mësuesit përfshin informimin e nxënësve për:

- A) Ritmin e materialit të ri që do të mësohet

- B) Sjelljen që ata duhet të përvetësojnë
- C) Përcaktimin e qëllimeve të mësimit
- D) Përzgjedhjen e përmbajtjes së materialit të ri

Pyetja 25

Procesi, i cili ndihmon nxënësin për të kuptuar konceptet, lidhjet shkak-pasojë, procedurat, qëllimet dhe objektivat, quhet:

- A) Shpjegim
- B) Demonstrim
- C) Eksperiment
- D) E nxënë e qëllimshme

Pyetja 26

Gjatë procesit të mësimit, trajtimi dhe shpjegimi i termave të reja me një gjuhë të përshtatshme dhe të saktë nga ana e mësuesit, arrihet përmes:

- A) Organizimit të nxënësve gjatë orës së mësimit
- B) Theksimit të ideve dhe ngjalljes së interesit
- C) Përdorimit të shembujve gjatë orës së mësimit
- D) Qartësisë dhe rrjedhshmërisë gjatë procesit të mësimit

Pyetja 27

Përdorimi i mirë i zërit, gjesteve, materialeve ndihmëse dhe perifrimit nga ana e mësuesit arrihet përmes:

- A) Analizës dhe komentit gjatë shpjegimit
- B) Tërheqjes së vëmendjes së vazhdueshme të nxënësve
- C) Menaxhimit të konflikteve në klasë
- D) Theksimit të ideve dhe ngjalljes së interesit

Pyetja 28

Foljet, që i korrespondojnë objektivave që janë të përshtatshme për mësimit, e drejtpërdrejtë, janë:

- A) Folje vepruese
- B) Folje aktive
- C) Folje pasive
- D) Folje jovepruese

Pyetja 29

Marrja, disponueshmëria si edhe aktivizimi nga ana e nxënësve, janë kushtet themelore për:

- A) Të nxënësin e kuptimshëm
- B) Motivimin e nxënësve
- C) Aktivizimin e nxënësve

D) Punën në grupe të nxënësve

Pyetja 30

Mendimi kritik ka të bëjë me:

- A) Mënyrën e të kritikuarit të nxënësve rreth ideve të tyre
- B) Disa aftësi intelektuale të nxënësve gjatë procesit të të mësuarit
- C) Kompetencat analitike dhe përshkruese të nxënësve gjatë orës së mësimit
- D) Një proces intelektual të disiplinuar që përfshin nivelet e larta të të menduarit

Pyetja 31

Modelet e përqëndruara në mësimdhënien e shprehive të veçuara dhe mësimin e fakteve:

- A) Rrisin zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve
- B) Nuk ndikojnë në procesin e të menduarit kritik të nxënësve
- C) E zvogëlojnë zhvillimin e të menduarit kritik të nxënësve
- D) Rrisin shprehitë praktike të nxënësve gjatë orës së mësimit

Pyetja 32

Përcaktime të plota për të nxënin dhe të menduarin mbështeten nga studiuesit e:

- A) Psikologjisë organizacionale dhe psikologjisë së punës
- B) Psikologjisë kognitive, filozofisë dhe edukimit shumëkulturor
- C) Psikologjisë klinike dhe psikologjisë së këshillimit
- D) Psikologjisë së personalitetit dhe psikologjisë sociale

Pyetja 33

Shprehitë për të nxënë, të ndara nga detyrat dhe qëllimet e botës reale, u japin mundësinë nxënësve të kryejnë një test objektiv, por ata janë:

- A) Të paaftë t'i zbatojnë këto shprehi në situata të reja
- B) Të aftë t'i zbatojnë këto shprehi në situata të reja
- C) Të paaftë t'i zbatojnë këto shprehi në situata të njohura
- D) Të aftë t'i zbatojnë këto shprehi si në situata të njohura ashtu edhe në situata të reja

Pyetja 34

Përdorimi nga mësuesi i strategjive, të cilat zhvillojnë shprehitë e të menduarit të nivelit të lartë për të mësuarin:

- A) Nuk ndikon në të nxënë e nxënësve
- B) E zgjeron të nxënë e nxënësve
- C) E ngushton të nxënë e nxënësve
- D) Varet edhe nga nxënësi

Pyetja 35

Pyetje të tilla si: “Çfarë prisni të mësoni rreth kësaj teme? Çfarë dini rreth saj?”- bëhen nga mësuesi në fazën e:

- A) Kontrollit frontal
- B) Reflektimit
- C) Realizimit të kuptimit
- D) Evokimit

Pyetja 36

Pyetje të tilla si: “Çfarë mësuar rreth kësaj teme? Pse mendoni kështu?”- bëhen nga mësuesi në fazën e:

- A) Realizimit të kuptimit
- B) Evokimit
- C) Kontrollit frontal
- D) Reflektimit

Pyetja 37

Gjatë procesit të të nxënës, nxënësit arrijnë të bëhen të vetëdijshëm dhe kontrollojnë proceset e tyre metanlohëse, nëse ata bëhen të aftë për të kuptuar ide dhe skema të reja dhe gjithashtu interpretojnë:

- A) Vetëm informacionin që kanë mësuar në klasë
- B) Situata të thjeshta problemore që i kanë zgjidhur së bashku
- C) Mënyrat e reja të vendosjes së bashku të informacionit dhe të koncepteve
- D) Rezultatet e eksperimenteve që kanë zhvilluar në klasë

Pyetja 38

Procesi, në të cilin nxënësit mendojnë rreth të menduarit të tyre, është:

- A) Njohës
- B) Eksplorues
- C) Vrojtues
- D) Metanlohës

Pyetja 39

Gjatë një ore mësimi, në rastet kur duhet të përvetësohen një numër i vogël faktesh, rregullash apo veprimesh zbatuese, përpara se të fillohet me një koncept, model apo abstragim, mësuesi mund të përdorë:

- A) Modelin e mësimdhënies jo të drejtpërdrejtë
- B) Modelin e mësimdhënies së drejtpërdrejtë
- C) Modele të kombinuara të mësimdhënies
- D) Modelin e leksionit interaktiv

Pyetja 40

Përforcimi i të nxënit të ri, apo rindërtimi i skemave për të përshtatur konceptet e reja, realizohet gjatë fazës së:

- A) Evokimit
- B) Reflektimit
- C) Realizimit të kuptimit
- D) Zgjidhjes së një situatë problemore

Pyetja 41

Struktura ERR është një strukturë:

- A) E nxjerrë nga përvoja e gjatë në fushën e mësimdhënies
- B) E improvizuar gjatë orës së mësimi
- C) E nxjerrë nga përvoja, studimet dhe eksperimentimet e shumta
- D) E nxjerrë nga teoria dhe e mbështetur nga praktika

Pyetja 42

Etiketimet që ne u vendosim ideve, që mund të jenë të thjeshta ose që mund të kenë një kompleks kuptimesh, janë:

- A) Konceptet
- B) Abstragimet
- C) Rrjedhimet
- D) Faktet

Pyetja 43

Organizuesit e informacionit në mënyrë grafike janë edhe:

- A) Sistemet ndërvepruese të shënimeve
- B) Organizuesit grafikë të analogjisë
- C) Rishikimet në dyshe
- D) Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Pyetja 44

Kontakti me idetë apo me informacionin e ri që mund të realizohet gjatë orës së mësimi, me anë të leximit të tekstit, shikimit të një filmi apo bërjes së një eksperimenti, realizohet gjatë fazës së:

- A) Evokimit
- B) Reflektimit
- C) Realizimit të kuptimit
- D) Zgjidhjes së një situatë problemore

Pyetja 45

Mësimi i fakteve, rregullave dhe veprimeve zbatuese është objektiv i:

- A) Mësimdhënies së drejtpërdrejtë
- B) Mësimdhënies jo të drejtpërdrejtë

- C) Mësimdhënies së drejtpërdrejtë dhe asaj jo të drejtpërdrejtë
- D) Të nxënësve interaktiv

Pyetja 46

Nxënësist zgjerojnë kuptimin e tyre për fjalorin kryesor dhe konceptet përtej përkufizimeve të thjeshta me anë të:

- A) Organizuesve grafikë
- B) Pyetje autorit
- C) Parashikimit me terma paraprakë
- D) Marrëdhënies pyetje-përgjigje

Pyetja 47

Modeli i mësimdhënies i cili realizohet përmes strategjive që nxisin procesin e përgjithsimit dhe dallimit, për qëllimin e formimit të koncepteve, medeleve dhe abstragimeve është modeli i:

- A) Mësimdhënies jo të drejtpërdrejtë
- B) Mësimdhënies së drejtpërdrejtë
- C) Mësimdhënies së drejtpërdrejtë dhe asaj jo të drejtpërdrejtë
- D) Mbajtjes së strukturuar të shënimeve

Pyetja 48

Gjallërimi i të menduarit të nxënësve, sigurimi i një diskutimi të pasur, motivimi i të nxënësve të nxënësve, nxitja e ndryshimeve dhe reflektimeve dhe vetëshprehjes, realizohet me anë të:

- A) Shpjegimit
- B) Demonstrimit
- C) Leksionit
- D) Strukturës ERR

Pyetja 49

Përdorimi i hartave njohëse-konjitive, gjatë procesit të mësimdhënies, janë një ndihmë shumë e madhe për zhvillimin e:

- A) Aftësive kinestetike
- B) Kujtesës dhe koncepteve
- C) Aftësive motorike
- D) Aftësive afektive

Pyetja 50

Struktura për mësimdhënien dhe zhvillimin e të menduarit kritik përban fazat e:

- A) Kontrollit frontal, kontrollit të dijes dhe shpjegimit të informacionit të ri
- B) Përsëritjes, paraqitjes së materialit të ri dhe praktikës së drejtuar
- C) Shpjegimit, praktikës së drejtuar dhe praktikës së pavarur
- D) Evokimit, realizimit të kuptimit dhe reflektimit

Pyetja 51

Klasifikojmë sipas nivelit të ulët ato pyetje që kërkojnë:

- A) Riprodhim informacioni
- B) Qartësim dhe zgjerim
- C) Përgjithsim
- D) Përfundim

Pyetja 52

Çdo formulim, me shkrim ose me gojë, që nxit të menduarit dhe kërkon nga nxënësit një përgjigje, do ta quajmë:

- A) Hipotezë
- B) Kërkesë
- C) Pyetje
- D) Përgjigje

Pyetja 53

Klasifikojmë sipas nivelit të lartë ato pyetje që kërkojnë:

- A) Riprodhim dhe zbatim të informacionit
- B) Qartësim, zgjerim dhe përfundim të informacionit
- C) Njohje dhe analizë të informacionit
- D) Kuptim dhe rivlerësim të informacionit

Pyetja 54

Gjatë bërjes së pyetjeve në klasë, mësuesi nuk ka qëllim që të:

- A) Tërheqë vëmendjen dhe të nxisë interesin e nxënësve
- B) Diagnostikojë dhe të strukturojë njohuritë e nxënësve
- C) Strukturojë dhe riorientojë të nxënësit e nxënësve
- D) Deprivojë nxënësit nga procesi i të nxënësve

Pyetja 55

Sasia e pyetjeve që mësuesi zhvillon në klasë:

- A) Ndikon në cilësinë e pyetjeve
- B) Nuk ndikon në cilësinë e tyre
- C) Varet nga mësuesi
- D) Varet nga nxënësit

Pyetja 56

Nëse mësuesit do të kualifikoheshin më tepër për të përdorur teknikat e të pyeturit:

- A) Do të rritet sasia dhe cilësia e pyetjeve të nivelit të lartë të përdorura në klasë

- B) Do të ulet sasia e pyetjeve të nivelit të lartë të përdorura në klasë
- C) Nuk do të ndikojë në tipin e pyetjeve të përdorura në klasë
- D) Do të ulet cilësia e pyetjeve të nivelit të lartë të përdorura në klasë

Pyetja 57

Pyetjet, të cilat i ftojnë nxënësit të reflektojnë, të mendojnë, të rindërtojnë, të përfytyrojnë apo të krijojnë:

- A) Ulin nivelin e të menduarit të nxënësve gjatë orës së mësimit
- B) Ngrehjnë nivelin e të menduarit të nxënësve në përgjithsi
- C) Nuk ndikojnë në nivelin e të menduarit të nxënësve
- D) Bëjnë që nxënësit të besojnë që niveli i të menduarit të tyre është i tepërt

Pyetja 58

Pyetjet që realizohen në klasë nga ana e mësuesit duhet të jenë:

- A) Të përgatitura që më parë
- B) Të papërgatitura
- C) Të improvizuara në klasë
- D) Në varësi të situatës që krijohet në klasë

Pyetja 59

Pyetjet të cilat kanë në bazë të tyre procesin e njohjes së gabimeve logjike në arsyetim:

- A) Krijojnë njohuri
- B) Abstrajojnë njohuri
- C) Analizojnë njohuri
- D) Zbatojnë njohuri

Pyetja 60

Burime të mëdha pyetjesh, që ndodh shpesh që të neglizhohen nga ana e mësuesit, vijnë edhe nga:

- A) Literatura
- B) Nxënësit
- C) Kolegët e tjerë
- D) Prindërit

Pyetja 61

Gjatë paraqitjes së materialit të ri mësimor gjatë orës së mësimit nuk është pjesë kryesore e tij:

- A) Vërtetësia e materialit mësimor
- B) Përzgjedhshmëria e materialit mësimor
- C) Llojshmëria e materialit mësimor
- D) Natyra e materialit mësimor

Pyetja 62

Pyetjet, të cilat çojnë në nxjerrjen e përgjigjeve të shumëfishta, janë pyetje:

- A) Divergjente
- B) Konvergjente
- C) Pyetje e vërtetë e gabuar
- D) Pyetje plotësuese

Pyetja 63

Nëse mësuesi merr përgjigje të ndryshme nga nxënësit, atëherë ai:

- A) Duhet t'i neglizhojë këto përgjigje
- B) Duhet t'i argumentojë këto përgjigje
- C) Ka një detyrim profesional që t'i pranojë ato
- D) Duhet t'i interpretojë këto përgjigje

Pyetja 64

Faza, në të cilën nxënësi është në gjendje të marrë vendime rreth vlerave apo metodave të vlefshme, ideve, njerëzve apo produkteve, sipas kriterëve të përdorura më pare, ka të bëjë me:

- A) Njohjen
- B) Vlerësimin
- C) Analizën
- D) Sintezën

Pyetja 65

Një folje që përdoret për pyetjet të cilat kërkojnë të kuptuarin e fakteve që nxënësi i ka të vendosura në kujtesën e tij është edhe folja:

- A) Emërto
- B) Demonstro
- C) Bashko
- D) Argumento

Pyetja 66

Faza, në të cilën nxënësi është në gjendje të kombinojë pjesët për të formuar një zgjidhje të veçantë apo të re të një problem, ka të bëjë me:

- A) Të kuptuarin
- B) Zbatimin
- C) Sintezën
- D) Gjykimin

Pyetja 67

Një folje që përdoret për pyetjet të cilat kërkojnë nga nxënësit që të formojnë gjykime dhe të marrin vendime duke u bazuar në kritere të vendosura që më parë, është folja:

- A) Krahaso
- B) Shpjego
- C) Zbato
- D) Vendos

Pyetja 68

Pyetja në të cilën nga nxënësit kërkohet që të bëhen dallime midis fakteve dhe përfundimeve ka të bëjë me fazën e:

- A) Njohjes
- B) Analizës
- C) Sintezës
- D) Zbatimit

Pyetja 69

Kubimi është një teknikë e bazuar në nivelin e:

- A) Pyetjeve
- B) Përgjigjeve
- C) Eksperimentit
- D) Demonstrimit

Pyetja 70

Nxënësit i krijohet mundësi për të menduar rreth përgjigjes së pyetjeve gjatë fazës së:

- A) Shpjegimit
- B) Të pyeturit
- C) Kohës së pritjes
- D) Demonstrimit

Pyetja 71

Rregullat të tilla si: bëj pyetjen-bëj një pauzë-pastaj drejtoju një nxënësi, janë rregullat e:

- A) Shtrimin të një situatae problemore
- B) Drejtimit të një pyetjeje
- C) Leksionit
- D) Shpjegimit

Pyetja 72

Mësuesi duhet ta nxisë një nxënës disa herë gjatë një seance pyetjesh, në mënyrë që:

- A) Të marrë një përgjigje të argumentuar
- B) Të marrë një përgjigje të plotë
- C) Të marrë një përgjigje sa më të plotë dhe logjike

D) Ta mbajë nxënësin të aktivizuar

Pyetja 73

Mësuesi, në reagimin ndaj përgjigjeve jo të sakta nga ana e nxënësve, duhet të jetë:

- A) Neglizhent por i kujdesshëm
- B) I vëmendshëm dhe tolerant
- C) I matur dhe i vëmendshëm
- D) I duruar, i matur dhe i qetë

Pyetja 74

Mësuesi, përpara se të bëjë përzgjedhjen e veprimtarive të nxënësit, nuk merr parasysh:

- A) Fokusimin te sjellja individuale e nxënësit
- B) Natyrën e materialit të ri mësimor që do të paraqesë
- C) Tipin e të nxënësit të nxënësve në klasë
- D) Nivelin dhe nevojat e nxënësve në klasë

Pyetja 75

Mësuesi, i cili ngre në mësim vetëm një numër të kufizuar nxënësish, zakonisht ata nxënës që janë të suksesshëm dhe me oratori të lartë, paraqet:

- A) Një nxitës negativ tek shumica e nxënësve të klasës
- B) Një nxitës pozitiv tek shumica e nxënësve të klasës
- C) Një aktivizim të plotë të nxënësve të klasës
- D) Komunikim të mirë me nxënësit në klasë

Pyetja 76

Pyetjet nga ana e mësuesit duhet të zhvillohen me një gjuhë:

- A) Të ndërlikuar dhe nxitëse
- B) Të qartë dhe jo shumë të thjeshtë
- C) Motivuese dhe jo shumë të ndërlikuar
- D) Të thjeshtë dhe nxitëse

Pyetja 77

Për të krijuar një atmosferë ku të gjithë nxënësit dëgjojnë në mënyrë aktive, mësuesi duhet:

- A) Të pyesë gjatë mësimit vetëm nxënësit aktivë në klasë
- B) Të pyesë herë pas here për riformulimin e përgjigjeve nga ana e nxënësve
- C) Të aktivizojë gjatë mësimit të gjithë nxënësit në klasë
- D) Të aktivizojë vetëm nxënësit më pak aktivë në klasë

Pyetja 78

Pyetje të tilla si: “Pse është ky përfundim? Pse kanë dalë këto rezultate?” etj, ndihmojnë që nxënësi të:

- A) Argumentojë çdo përgjigje
- B) Të njohë faktet
- C) Të dijë përgjigjet
- D) Të dijë të zgjidhë situatat problemore

Pyetja 79

Një pyetje e suksesshme që realizohet nga mësuesi në klasë varet më shumë nga:

- A) Shprehja e fytyrës e mësuesit
- B) Konteksti në të cilën ajo bëhet
- C) Intonacioni i zërit dhe konteksti në të cilën ajo bëhet
- D) Gjuha kinestetike me të cilën ajo shoqërohet

Pyetja 80

Teknika e të pyeturit ndërveprues:

- A) Rrit komunikimi në klasë duke nxitur përgjigjet e shumëfishta
- B) Nuk i lë fushë të lirë veprimit të nxënësve
- C) Zhvillon vetëm shprehitë e nivelit të ulët të të menduarit të nxënësve
- D) I lë fushë të lirë vetëm veprimit të mësuesit në klasë

Pyetja 81

Shprehja, në bazë të të cilës kalohet nga standartet, tek vlerësimi dhe tek mësimdhënia dhe që shërben për zhvillimin e të menduarit, gjuhës dhe përmbajtjes, është një nga shprehitë bazë:

- A) Të mësuesve
- B) Të nxënësve
- C) Të prindërve
- D) Të drejtuesve të institucioneve arsimore

Pyetja 82

Mësuesi duhet të përdorë gjuhën e duhur, për t'i bërë nxënësit të përdorin dhe të kultivojnë të menduarin shkollor:

- A) Vetëm gjatë shpjegimit të informacionit të ri
- B) Vetëm kur bën pyetje në klasë
- C) Gjatë gjithë ushtrimit të detyrës së tij si mësues
- D) Vetëm gjatë ndërtimit të artikujve testues

Pyetja 83

Është shprehja e të menduarit shkollor:

- A) Kompetenca analitiko-përshkruese
- B) Identifikimi i shkak-pasojës

- C) Inteligjenca emocionale
- D) Inteligjenca hapësinore

Pyetja 84

Mësuesi gjatë punës së tij të përditshme duhet të krijojë një fond të praktikave më të mira dhe duhet t'i:

- A) Rishohë herë pas here
- B) Zhvillojë ato vazhdimisht
- C) Ndajë me kolegët
- D) Konservojë ato me shumë kujdes

Pyetja 85

Nxënësit të cilët gjatë mësimit shtrojnë pyetje të tilla si: “Cili është qëllimi i tekstit?, A jepen fakte mbështetëse të besueshme?, A mbështeten përfundimet në faktet e dhëna?”, janë ata nxënës që dinë:

- A) Të shtrojnë pyetje mbi një situatë të caktuar
- B) Të zgjidhin si duhet një situatë problemore
- C) Të nxjerin faktet e duhura nga një tekst
- D) Të bëjnë mirë analizat kritike të teksteve

Pyetja 86

Mbajtje shënimesh me kode të të menduarit është një mënyrë për të:

- A) Shkruar një tekst të dhënë
- B) Analizuar një tekst të dhënë
- C) Argumentuar një tekst të dhënë
- D) Redaktuar një tekst të dhënë

Pyetja 87

Krahasimi, ku përfshihet edhe kontrasti apo përqsaja, do të thotë që nxënësi të:

- A) Gjejë ngjashmëritë dhe dallimet midis dy apo më shumë sendeve
- B) Zbërthejë një ngjarje apo koncept në cilësitë e tij përbërëse
- C) Bëjë pyetje gjatë ripërforcimit të njohurive
- D) Përdorë konceptet në kontekste të reja

Pyetja 88

Procesi i të nxënit bashkëpunues, që i aftëson nxënësit të punojnë në grupe të vogla të larmishme dhe heterogjene në përbërje, realizohet me anë të përdorimit të teknikës:

- A) Rrjeti i diskutimit
- B) Ditaret e të nxënit
- C) Pyetja sjell pyetjen
- D) Pyetje drejtuar autorit

Pyetja 89

Sigurimi i komenteve dhe informacionit gjatë procesit të bashkëbisedimit të mësuesit me nxënësit në klasë, që ju tregon nxënësve saktësinë e përvetsimit të përgjigjeve të tyre mbi të gjitha, nuk synon:

- A) Përkrahjen për të mësuar më mirë
- B) Ritmin e përvetësimit të informacionit të ri
- C) Krijimin e një klime miqësore në klasë
- D) Vlerësimin individual të nxënësve në klasë

Pyetja 90

Shprehia e të menduarit të nivelit të lartë, e cila është një pikënisje shumë e mirë për të bërë pyetje të tjera më të thella për përmbajtjen, ka të bëjë me:

- A) Zgjidhjen e problemave
- B) Identifikimin e shkakut dhe të pasojës
- C) Kategorizimin dhe klasifikimin
- D) Analizën e një problemi praktik

Pyetja 91

Zgjidhja e problemave krijuese ju kërkon nxënësve që:

- A) Të zbatojnë zgjidhjet edhe në rrethanat e jetës së përditshme
- B) Të japin përgjigje të shumta
- C) Të bëjnë analizë për të gjetur zgjidhjen
- D) Të kategorizojnë konceptet për të gjetur zgjidhjen

Pyetja 92

Në shprehitë mbështetëse për argumentimin dhe të menduarin bindës përfshihen sidomos edhe:

- A) Njohja, kuptimi i njohurive të reja dhe zbatimi
- B) Vënia e vëhtes në pozicionin e tjetrit dhe vlerësimi
- C) Analiza, krahasimi, vlerësimi dhe sintetizimi
- D) Ristrukturimi i ideve dhe skemave konceptuale

Pyetja 93

Një nga nënshprehitë më të rëndësishme për zgjidhjen e problemave krijuese nuk është:

- A) Këmbëngulja dhe vënia nën kontroll e impulsivitetit
- B) Të menduarit fleksibël dhe bërja e pyetjeve të mira
- C) Zbatimi i njohurive të mëparshme në situata të reja
- D) Procesi i të vepruarit dhe të menduarit si të tjerët

Pyetja 94

“Mbështete në prova” është një teknikë e cila zhvillon te nxënësit shprehinë e:

- A) Kategorizimit dhe klasifikimit
- B) Argumentimit/Të menduarit bindës
- C) Vënies së vehtes në pozicionin e tjetrit
- D) Zgjidhjes së problemave krijuese

Pyetja 95

Vënia e vehtes në vëndin e tjetrit jo vetëm përmirëson shprehitë sociale të nxënësit, por përmirëson edhe:

- A) Aftësinë e tij të për të menduar në nivel më të lartë dhe për të arritur sukses
- B) Kompetencat përshkruese të nxënësit gjatë procesit të të nxënit
- C) Zhvillimin e tij motor gjatë aktiviteteve shkollore dhe jashtë saj
- D) Kompetencat analitike dhe interpretuese të nxënësit në jetë

Pyetja 96

Aftësia për të bërë lidhje dhe për të krijuar këndvështrime gjithnjë e më të gjera, është shprehi e të menduarit të nivelit të lartë që ka të bëjë me:

- A) Analizën
- B) Zgjidhjen e problemave
- C) Sintezën
- D) Empatinë

Pyetja 97

Interpretimi është ajo shprehi që bën që nxënësit të kuptojnë shumë nga mesazhet të cilat:

- A) Nuk thuhet në mënyrë të drejtpërdrejtë
- B) Thuhet në mënyrë të drejtpërdrejtë
- C) Nuk thuhet fare gjatë komunikimit
- D) Lihen të nënkuptohen gjatë komunikimit

Pyetja 98

Deshifrimet dhe përdorimet e gjuhës figurative, si analogjitë, metaforat, simbolet dhe fjalët me shumë kuptime, janë në funksion të:

- A) Analizës
- B) Sintezës
- C) Argumentimit/Të menduarit bindës
- D) Interpretimit

Pyetja 99

Aftësia informacion - përpunuese dhe që është një nga nivelet më të larta të të menduarit nga ana e nxënësve, është aftësia e:

- A) Identifikimit të shkakut dhe të pasojës

- B) Vlerësimi
- C) Argumentimi/Të menduarit bindës
- D) Interpretimi

Pyetja 100

Zgjidhja e problemeve nga ana e nxënësve duke zgjedhur dhe përdorur teknikat më të mira ka të bëjë me shprehinë e:

- A) Empatisë
- B) Krahasimit
- C) Zbatimit
- D) Analizës

Pyetja 101

Metoda e mësimdhënies, e cila ka në qendër nxënësin dhe karakterizohet nga një procedurë formale për paraqitjen e argumentave për një çështje, ku njëri prej grupeve është pro problemit, tjetri është kundër, konsiderohet si:

- A) Debat konstruktiv
- B) Ditaret e të nxënit
- C) Rrjet i diskutimit
- D) Rishikim në dyshe

Pyetja102

Metoda ku nxënësit nxiten të hulumtojnë dhe të gjejnë një zgjidhje për problemin e paraqitur, ka të bëjë me:

- A) Rrjetin e diskutimit
- B) Përvijimin e të menduarit
- C) Pyetja sjell pyetjen
- D) Zgjidhjen e problemit

Pyetja 103

Stuhia e mendimeve, metoda që përdoret gjatë mësimdhënies me në qendër nxënësin, nuk i ndihmon nxënësit të:

- A) Zhvillojnë idenë e të menduarit sa më të gjërë
- B) Zhvillojnë idenë e të menduarit të thellë dhe përfytyrues
- C) Zhvillojnë të menduarin lateral
- D) Zhvillojnë aftësitë e tyre motorike

Pyetja 104

Gjatë diskutimeve të cilat dalin në klasë, nxënësit mund ti vendosin pyetjet e tyre në:

- A) Tabelë të zezë
- B) Në banka

- C) Tabelën e pyetjeve
- D) Nëpër mure

Pyetja105

Shkrimi i shpejtë, një metodë e cila përdoret nga mësuesit, ka të bëjë me:

- A) Nxjerrjen e argumentave
- B) Reflektimin e shkurtër për një temë
- C) Organizimin formal gjuhësor të thënieve
- D) Shkrimin e ideve kryesore

Pyetja106

Nëse mësuesi për procesin e vlerësimit ka ndjekur hapa të tillë si: ka vëzhguar se si është pjesëmarrja e nxënësve në veprimtarinë mësimore, ka vlerësuar të nxënën e përmbajtjes dhe sa janë kuptuar idetë, ka vlerësuar aftësinë e nxënësve për të mbajtur një qëndrim dhe për ta mbështetur atë me prova, ai ka zhvilluar:

- A) Një orë mësimdhënie me në qendër nxënësin
- B) Një orë mësimdhënie me në qendër mësuesin
- C) Një orë leksioni bashkëveprues me të gjithë nxënësit
- D) Një orë paratestimi diagnostikues për nxënësit

Pyetja 107

Të dëgjuarit kritik është zbatimi i shprehive të:

- A) Argumentimit
- B) Vënies së vehtes në pozitën e tjetrit
- C) Sintezës
- D) Të menduarit kritik

Pyetja 108

Përdorimi i metodave të tilla nga mësuesi në klasë, Mendo/Krijo në dyshe/Diskuto, gjatë zhvillimit të mësimit, ndihmojnë që nxënësit të:

- A) Kuptojnë argumentat
- B) Zhvillojnë kompetencat afektive
- C) Zhvillojnë kompetencat relacionale
- D) Zhvillojnë shprehitë motore

Pyetja 109

Nëse mësuesi gjatë mësimit përdor metodën D.D.M (Di-Dua të di-Mësova), ka aktivizuar te nxënësit:

- A) Të menduarin induktiv
- B) Të menduarin deduktiv
- C) Të menduarin abstragues

D) Të menduarin kritik

Pyetja 110

Pjesa e orës së mësimi në të cilën nxënësit mendojnë përsëri për atë që kanë mësuar, zbatojnë idetë dhe rishqyrtojnë çka dinin më parë, nën dritën e asaj që ata kanë mësuar, është pjesë e:

- A) Mësimdhënies së drejtëpërdrejtë
- B) Mësimdhënies jo të drejtëpërdrejtë
- C) Mësimdhënies bihejvioriste
- D) Mësimdhënies tradicionale

Pyetja 111

Elementë të tillë si: njohuri për qëllimet dhe objektivat mësimore, njohuri për karakteristikat e nxënësve, njohuri për lëndën, njohuri për metodat mësimore, janë të domosdoshme për mësuesin për:

- A) Planifikimin e mësimdhënies
- B) Menaxhimin e kohës
- C) Menaxhimin e klasës
- D) Organizimin e veprimtarive mësimore

Pyetja 112

Teknika e mësimdhënies, e cila ndërtohet me qëllimin që nxënësit të fitojnë shprehje që të nxjerrin në pah se çfarë ka dashur autori të thotë, nisur nga këndvështrime të ndryshme në tekst, është:

- A) Pyetja sjell pyetjen
- B) Sistemi ndërveprues i shënimeve
- C) Rrjeti i diskutimit
- D) Teknika e pyetjeve drejtuar autorit

Pyetja 113

Fazat e interpretimit, përshkrimit dhe arsuedhënies nga ana e mësuesit janë pjesë e:

- A) Zgjidhjes së një problemi
- B) Ndërtimit të një modeli demonstrues
- C) Shpjegimit të informacionit të ri
- D) Reflektimit

Pyetja 114

Evokimi, si fazë e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë nga ana e nxënësit, nuk ka për qëllim kryesor:

- A) Njohjen me njohuritë duke i mbështetur në njohuritë paraprirëse
- B) Shkëmbimin e fuqishëm të ideve midis nxënësve
- C) Rritjen e veprimtarive të nxënësit

D) Zhvillimin e arsytimit të vijueshëm nga ana e nxënësve

Pyetja 115

Përdorimi i metodave për zhvillimin e të menduarit kritik dhe krijues nga ana e nxënësve, siç është edhe metoda e organizuesit grafik, nuk i ndihmon nxënësit për:

- A) Nxitjen për të përsosur të shkruarin
- B) Formimin, zgjerimin dhe të kuptuarin e koncepteve
- C) Paraqitjen pamore të koncepteve
- D) Integrimin e plotë të njohurive që ata kanë marrë

Pyetja 116

Pyetjet konvergjente janë pyetje që:

- A) Nuk përqëndrohen në një objektiv të ngushtë
- B) Çojnë në një grup të përbashkët përgjigjesh
- C) Nuk plotësojnë kriterin e kufizimeve të përgjigjeve të nxënësve
- D) Kërkojnë shprehje të larta të të menduarit nga ana e nxënësve

Pyetja 117

Mësuesi duhet të përdorë shumë në klasë pyetje që kërkojnë:

- A) Vetëm memorizim
- B) Vetëm fakte
- C) Përgjigje të shumëfishta
- D) Vetëm zbatim

Pyetja 118

Procesi, gjatë të cilit nxënësit duhet të bëjnë përgjithsime dhe të nxjerrin parime mbi bazën e vëzhgimeve dhe të analizës, është një proces:

- A) Deduktiv
- B) Abstragues
- C) Induktiv
- D) Krijues

Pyetja 119

Modeli me katër pjesë, i cili përdoret për formulimin e pyetjeve për zhvillimin e të menduarit kritik, nuk përfshin të kuptuarin:

- A) E përgjithshëm
- B) Interpretues
- C) Vetjak dhe kritik
- D) Afektiv

Pyetja 120

Pyetjet e nivelit të sintezës që realizohen në klasë gjatë procesit të mësimdhënies dhe të nxënies nuk i kërkojnë nxëniesit që të:

- A) Shkruajë një temë të organizuar mirë
- B) Interpretojë grafikë dhe diagrama
- C) Propozojë planin e një projekti shkencor
- D) Formulojë një skemë të re për të klasifikuar ngjarje ose ide

PROGRAMI I PËRBASHKËT I PEDAGOGJISË
PJESA E TRETË
BLLOKU I AFTËSIVE NDËRKURIKULARE

Pyetja 1

Cila nga alternativat e mëposhtme është e saktë?

- A) Përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit të kuptojnë çfarë është prindërimi
- B) Përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit të marrin një profesion
- C) Përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit në ndërtimin e marrëdhënieve të mira me komunitetin
- D) Përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit në rritjen e financave familjare

Pyetja 2

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e saktë?

- A) Përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit të kuptojnë çfarë është prindërimi
- B) Përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim t'u japë prindërve informacion rreth çështjeve që mund të ndikojnë në jetën e fëmijëve të tyre
- C) Përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit të marrin një profesion në jetë
- D) Përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit në gjetjen e rrugëve për të mbështetur fëmijët në shkollë

Pyetja 3

Prindërit kanë role të ndryshme në edukim. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e saktë, lidhur me rolet e prindërve në edukim?

- A) Prindërit si partnerë
- B) Prindërit si zgjidhës të problemeve të shkollës
- C) Prindërit si vëzhgues
- D) Prindërit si mësimdhënës

Pyetja 4

Prindërit kanë role të ndryshme në edukim. Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e saktë, lidhur me rolet e prindërve në edukim?

- A) Prindërit si hartues të programeve mësimore.
- B) Prindërit si këshillues dhe partnerë në vendimmarrjen e shkollës
- C) Prindërit si vullnetarë
- D) Prindërit si partnerë

Pyetja 5

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk është e saktë?

- A) Prindit duhet t'i kërkohet të japë mendimin e tij para se të hartohen politikat për shkollën dhe të bëhen planifikime
- B) Edukimi është një rol jo i përshtatshëm për prindin, ai duhet t'u lihet në dorë vetëm profesionistëve
- C) Prindërit duhet të jenë pjesë e procesit të zgjedhjes së teksteve mësimore
- D) Prindërit duhet të marrin pjesë në aktivitetet që organizohen në shkollë

Pyetja 6

Cila nga alternativat e mëposhtme është e saktë?

- A) Është përgjegjësi e prindërve vendosja e disiplinës së nxënësve në klasë
- B) Është përgjegjësi e prindërve hartimi dhe rishikimi i programeve mësimore
- C) Është përgjegjësi e prindërve aktivizimi i nxënësve në orën e mësimit
- D) Është përgjegjësi e prindërve krijimi i kushteve të përshtatshme për studim të nxënësit

Pyetja 7

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk duhet të përfshihet në marrëveshjen midis prindit dhe shkollës?

- A) Unë si prind marr përsipër të krijoj një mjedis ku fëmija im të studiojë i qetë dhe të kujdesem që ai të mësojë sistematikisht
- B) Unë si prind marr përsipër të flas me fëmijën për veprimtaritë e tij çdo ditë
- C) Unë si prind marr përsipër t'i shpjegoj detyrat e shtëpisë fëmijës tim sa herë që ai ka vështirësi ti bëjë ato
- D) Unë si prind marr përsipër të marr pjesë në takimet me prindër sa herë që ato organizohen

Pyetja 8

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk duhet të përfshihet në marrëveshjen midis prindit dhe shkollës?

- A) Unë si prind marr përsipër të angazhohem në punët e shkollës
- B) Unë si prind marr përsipër që fëmija im të jetë i vëmendshëm në çdo orë mësimi
- C) Unë si prind marr përsipër të inkurajoj fëmijën të lexojë
- D) Unë si prind marr përsipër të orientoj fëmijën tim që të shohë programe të përshtatshme televizive

Pyetja 9

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk duhet të përfshihet në marrëveshjen midis mësuesit dhe prindit?

- A) Unë si mësues marr përsipër t'i siguroj çdo nxënësi tekstet dhe materialet e tjera individuale të domosdoshme për mësim
- B) Unë si mësues marr përsipër të motivoj nxënësit duke bërë mësim sa më interesant
- C) Unë si mësues marr përsipër t'u bëj të qartë nxënësve dhe prindërve synimet dhe mënyrat e mia të vlerësimit
- D) Unë si mësues marr përsipër të përdor metoda dhe materiale mësimore që janë të përshtatshme për çdo nxënës

Pyetja 10

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk duhet të përfshihet në marrëveshjen midis mësuesit dhe prindit?

- A) Unë si mësues marr përsipër t'u shpjegoj nxënësve dhe prindërve rregulloren e shkollës
- B) Unë si mësues marr përsipër të punoj me çdo prind për të siguruar një arsimim sa më të mirë të fëmijëve të tyre
- C) Unë si mësues marr përsipër të krijoj në klasë një mjedis të përshtatshëm për të mësuar
- D) Unë si mësues marr përsipër të krijoj një mjedis ku nxënësi të studiojë i qetë dhe sistematikisht

Pyetja 11

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk duhet të përfshihet në marrëveshjen midis mësuesit dhe prindit?

- A) Unë si mësues marr përsipër të njoftoj vazhdimisht prindërit për përparimin e fëmijëve të tyre
- B) Unë si mësues marr përsipër t'i bëj të qarta gjërat që shpjegoj në mënyrë që nxënësi t'i kuptojë sa më mirë
- C) Unë si mësues marr përsipër të siguroj që nxënësi të vijë në shkollë në kohën e duhur dhe i përgatitur
- D) Unë si mësues marr përsipër të krijoj një mjedis të mësuarit sa më të sigurt për nxënësin

Pyetja 12

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk duhet të përfshihet në marrëveshjen midis drejtorit të shkollës dhe prindit?

- A) Unë si drejtor i shkollës marr përsipër të krijoj një mjedis mikpritës për nxënësit
- B) Unë si drejtor i shkollës marr përsipër të inkurajoj lidhjet midis nxënësve, prindërve dhe mësuesve
- C) Unë si drejtor i shkollës marr përsipër të krijoj një ambient të sigurt për nxënësit në shtëpi
- D) Unë si drejtor i shkollës marr përsipër të organizoj një sistem trajnimi për prindërit

Pyetja 13

Cila nga alternativat e mëposhtme nuk duhet të përfshihet në marrëveshjen midis nxënësit dhe shkollës?

- A) Unë si nxënës marr përsipër të zbatoj rregulloren e shkollës
- B) Unë si nxënës marr përsipër të mësoj rregullisht çdo ditë
- C) Unë si nxënës marr përsipër të respektoj të drejtën e të tjerëve për të mësuar pa i shqetësuar dhe pa i ndërprerë
- D) Unë si nxënës marr përsipër t'i shpjegoj mësimin shokut të bankës sa herë që ai nuk e kupton

Pyetja 14

Një prind vullnetar në shkollë nuk mund të ndihmojë mësuesin në detyrën e mëposhtme:

- A) Për të mbledhur materiale për punën mësimore
- B) Për vlerësimin e nxënësve në klasë
- C) Për organizimin e bisedave në klasë

D) Për organizimin e ekskursioneve apo vizitave

Pyetja 15

Cila nga sjelljet e mëposhtme nuk është tipike për një njeri të motivuar?

- A) Sjellja e tij vazhdon të jetë e qëndrueshme
- B) Sjellja e tij është e drejtuar dhe e orientuar
- C) Patjetër ka filluar të bëjë diçka
- D) Shoqërohet nga një gjendje e ulët emocionale

Pyetja 16

Cila nga teoritë e mëposhtme për motivacionin nuk është e saktë?

- A) Motivacioni si reagim ndaj nevojës
- B) Motivacioni si reagim ndaj eksitimit të brendshëm
- C) Motivacioni si reagim ndaj pritshmërisë që ka njeriu për të tjerët
- D) Motivacioni si përpjekje konjitive për të kuptuar e realizuar qëllimet që ka njeriu

Pyetja 17

Me cilën nga teoritë e mëposhtme për motivacionin shpjegohet sjellja e mëposhtme:

“Energjizimi dhe ndërtimi i sjelljeve që mundësojnë sigurimin e ushqimit kur njeriu është i uritur”.

- A) Motivacioni si reagim ndaj nevojës
- B) Motivacioni si reagim ndaj eksitimit të brendshëm
- C) Motivacioni si reagim ndaj pritshmërisë që ka njeriu për veten
- D) Motivacioni si përpjekje konjitive për të kuptuar e realizuar qëllimet që ka njeriu

Pyetja 18

Me cilën nga teoritë e mëposhtme për motivacionin shpjegohet sjellja e mëposhtme: “Përpjekja që bën një nxënës i klasës së parë të arsimit fillor për të qenë i pari i klasës”.

- A) Motivacioni si reagim ndaj nevojës
- B) Motivacioni si reagim ndaj eksitimit të brendshëm
- C) Motivacioni si reagim ndaj pritshmërisë që ka njeriu për veten
- D) Motivacioni si përpjekje konjitive për të kuptuar e realizuar qëllimet që ka njeriu

Pyetja 19

Me cilën nga teoritë e mëposhtme për motivacionin shpjegohet sjellja e mëposhtme: “Përpjekja që bën, në lëndën e matematikës, një nxënës i klasës së parë gjimnaz, me qëllim që në vitin e fundit të gjimnazit të marrë pjesë dhe të marrë një çmim në olimpiadën e matematikës”.

- A) Motivacioni si reagim ndaj nevojës
- B) Motivacioni si reagim ndaj eksitimit të brendshëm
- C) Motivacioni si reagim ndaj pritshmërisë që ka njeriu për veten
- D) Motivacioni si përpjekje konjitive për të kuptuar e realizuar qëllimet që ka njeriu

Pyetja 20

Me cilën nga motivet që janë aktive në shkollë shpjegohet sjellja e mëposhtme: “Nxënësi i cili ka frikë se merr notë negative në matematikë shton përpjekjet për të mësuar”.

- A) Dëshira për të fituar miratimin e mësuesit
- B) Dëshira për të qenë i pari i klasës
- C) Dëshira për të hequr qafe pasigurinë
- D) Dëshira për kontroll, pushtet dhe status

Pyetja 21

Me cilën nga motivet që janë aktive në shkollë shpjegohet sjellja e mëposhtme: “Përpjekjet që bën nxënësi për t’u zgjedhur senator i shkollës”.

- A) Dëshira për të fituar miratimin e mësuesit
- B) Dëshira për të qenë i pari i klasës
- C) Dëshira për të hequr qafe pasigurinë
- D) Dëshira për kontroll, pushtet dhe status

Pyetja 22

Me cilën nga motivet që janë aktive në shkollë shpjegohet sjellja e mëposhtme: “Përpjekjet që bën nxënësi për të arritur një standard të lartë në një lëndë të caktuar”.

- A) Dëshira për të fituar miratimin e mësuesit
- B) Dëshira për të qenë i pari i klasës
- C) Dëshira për të hequr qafe pasigurinë
- D) Dëshira për kontroll, pushtet dhe status

Pyetja 23

Cilën nga veprimet e mëposhtme nuk duhet ta bëjnë prindërit me qëllim që të nxisin ambicien për sukses te fëmijët?

- A) Të inkurajojnë fëmijët të zgjidhin detyra të vështira
- B) I vlerësojnë fëmijët pozitivisht me fjalë dhe u japin shpërblime
- C) Prirën të zgjidhin vetë detyrën e vështirë
- D) I nxisin fëmijët të hedhin hapa edhe më të vështirë

Pyetja 24

Çfarë nuk duhet të bëjnë mësuesit me qëllim që të rrisin besimin e nxënësit në zotësitë personale?

- A) Të japë detyra të vogla e të nivelit mesatar
- B) Të përdorë kriterë të njohura që më parë nga nxënësit për vlerësimin e performancës
- C) Të ofrojë feedback rregullisht gjatë kryerjes së detyrës dhe në fund të saj
- D) Të ndëshkojë nëse nxënësi nuk realizon detyrën

Pyetja 25

Çfarë nuk duhet të bëjnë mësuesit me qëllim që të rrisin besimin e nxënësit në zotësitë personale?

- A) T'u ofrojë nxënësve detyra të nivelit të lartë të vështirësisë
- B) T'i ofrojë nxënësit inkurajim për realizimet e tij
- C) T'i përfshijë nxënësit në planifikim për realizimin e detyrave dhe kapërcimin e pengesave
- D) T'u ofrojë nxënësve shpërblim për performancën e kryer

Pyetja 26

Çfarë nuk duhet të bëjnë mësuesit lidhur me mënyrën si i shpjegon sukseset dhe mos sukseset e nxënësit?

- A) Mësuesi duhet të reagojë në radhë të parë ndaj përpjekjeve që bën nxënësi dhe më pak ndaj rezultateve që ai arrin
- B) Mësuesi duhet të reagojë ndaj rezultateve konkrete të nxënësit dhe t'i krahasojë ato me rezultatet e nxënësve të tjerë
- C) Mësuesi duhet të theksojë më shumë çështjen e feedback-ut për saktësinë apo pasaktësinë e përgjigjeve të nxënësit e më pak me vlerësimin me notë të arritjeve të tij

D) Mësuesi duhet të reagojë më shumë ndaj performancës së nxënësit e më pak ndaj personalitetit të tij

Pyetja 27

Mësuesi mund t'ua ulë nxënësve motivacionin nëse:

- A) Nxit konkurrencën midis tyre
- B) Pakëson konkurrencën midis tyre
- C) Nxit të mësuarin kooperues
- D) Nxit të mësuarin në grupe

Pyetja 28

Nisur nga teknikat përforcuese, cili duhet të jetë reagimi i mësuesit në situatën e mëposhtme?

“Nxënësit sa janë kthyer nga pushimi në klasë. Hyn mësuesi në klasë dhe disa nxënës i gjen ulur në vendet e tyre dhe disa të tjerë janë duke ndjekur njëri-tjetrin ose duke biseduar me zë të lartë”,

- A) U tërheq vëmendjen nxënësve që bisedojnë
- B) U tërheq vëmendjen nxënësve që janë duke ndjekur njëri-tjetrin
- C) Vlerëson nxënësit që kanë zënë vendet e tyre
- D) Injoron sjelljet e nxënësve

Pyetja 29

Nisur nga teknikat përforcuese, cili duhet të jetë reagimi i mësuesit për situatën e mëposhtme?

“Gjatë diskutimeve në klasë, nxënësve u është kërkuar që, nëse e duan fjalën duhet ta kërkojnë duke ngritur dorën. Ndërkohë një pjesë e nxënësve thërrasin për të marrë fjalën.”

- A) U tërheq vëmendjen nxënësve që thërrasin
- B) Injoron nxënësit që thërrasin dhe i jep fjalën një nxënësi që ka ngritur dorën
- C) Pret të vendoset qetësia në klasë pastaj ju jep fjalën nxënësve
- D) Injoron nxënësit që kanë ngritur dorën

Pyetja 30

Nisur nga teknikat përforcuese, cili duhet të jetë reagimi i mësuesit për situatën e mëposhtme?

“Ka rënë zilja për pushim dhe nxënësit po dalin nga klasa në oborr. Disa ecin qetësisht të tjerë vrapojnë duke shtyrë edhe shokët”

- A) U tërheq vëmendjen nxënësve që vrapojnë dhe shtyhen
- B) Pret datën e takimit me prindër dhe e diskuton me ta

- C) Injoron nxënësit që vrapojnë dhe vlerëson nxënësit që ecin qetësisht
- D) Injoron nxënësit që ecin qetësisht

Pyetja 31

Nisur nga teknikat përforcuese, cili duhet të jetë reagimi i mësuesit për situatën e mëposhtme?
 “Nxënësit në klasë janë duke kryer një detyrë me shkrim. Njëri prej tyre kopjon.”

- A) Vlerëson me notë negative nxënësin që kopjon
- B) I tërheq vëmendjen nxënësit që kopjon
- C) Pret datën e takimit me prindër për ta diskutuar me prindërit sjelljen e nxënësit që kopjo
- D) Injoron nxënësin që kopjon dhe vlerëson shokun e tij të bankës që punon me forcat e veta

Pyetja 32

Cili e rrit më tepër motivacionin e nxënësit?

- A) Ndëshkimi
- B) Qortimi
- C) Shpërblimi
- D) Korrigjimi

Pyetja 33

Cili lloj shpërblimi për të motivuar nxënësit, jep më tepër rezultat?

- A) I menjëhershëm
- B) I dhënë në fund të orës së mësimi
- C) I dhënë në fund të ditës së mësimi
- D) I dhënë në fund të semestrit

Pyetja 34

Sipas parimit të Premakut:

- A) Nxënësi që ka qejf të mësojë, ka qejf edhe të luajë
- B) Nxënësi që nuk ka qejf të mësojë, por ka qejf të luajë, vihet të mësojë me kusht që pasi të mësojë, shpërblehet duke u lejuar të luajë
- C) Nxënësi që ka qejf të mësojë, por nuk ka qejf të luajë, vihet të luajë me kusht që pasi të luajë, shpërblehet duke lejuar të mësojë
- D) Nxënësi që nuk ka qejf të mësojë, nuk ka qejf as të luajë

Pyetja 35

Cilit nga rolet e mësuesit i përket veprimtaria e mëposhtme: “Zhvillimi profesional i mësuesit”

- A) Roli i mësuesit si mësues
- B) Roli i mësuesit si shprehës i sjelljeve pozitive në klasë
- C) Roli i mësuesit si administrator
- D) Roli i mësuesit si qytetar

Pyetja 36

Cilit nga rolet e mësuesit i përket veprimtaria e mëposhtme: “Ndalimi i sjelljes poshtëruese ndaj nxënësit”

- A) Roli i mësuesit si mësues
- B) Roli i mësuesit si shprehës i sjelljeve pozitive në klasë
- C) Roli i mësuesit si administrator
- D) Roli i mësuesit si qytetar

Pyetja 37

Cilit nga rolet e mësuesit i përket veprimtaria e mëposhtme: “Shmangia e manive personale”

- A) Roli i mësuesit si mësues
- B) Roli i mësuesit si shprehës i sjelljeve pozitive në klasë
- C) Roli i mësuesit si administrator
- D) Roli i mësuesit si qytetar

Pyetja 38

Cilit nga rolet e mësuesit i përket veprimtaria e mëposhtme: “Vendosja e një ure bashkëpunimi të mësuesit me nxënësit nëpërmjet sjelljes konfidenciale”

- A) Roli i mësuesit si mësues
- B) Roli i mësuesit si shprehës i sjelljeve pozitive në klasë
- C) Roli i mësuesit si administrator
- D) Roli i mësuesit si qytetar

Pyetja 39

Cilit nga rolet e mësuesit i përket veprimtaria e mëposhtme: “Ruajtja me kujdes e dokumentacionit mbi të dhënat e përgjithshme të nxënësit”

- A) Roli i mësuesit si mësues
- B) Roli i mësuesit si shprehës i sjelljeve pozitive në klasë
- C) Roli i mësuesit si administrator
- D) Roli i mësuesit si qytetar

Pyetja 40

Cilit nga rolet e mësuesit i përket veprimtaria e mëposhtme: “Mënjanimi i ndjenjës së zemërimit”

- A) Roli i mësuesit si mësues
- B) Roli i mësuesit si shprehës i sjelljeve pozitive në klasë
- C) Roli i mësuesit si administrator
- D) Roli i mësuesit si qytetar

**PROGRAMIT PEDAGOGJISË
PJESA E KATËRT
“VLERESIMI NXENESVE ”**

Pyetja 1

Testet që mundësojnë sigurimin e informacionit për modele të sjelljes nën procedura uniforme janë edhe:

- A) Testet e përgatitura nga mësuesi
- B) Testet e shpejtësisë
- C) Testet e arritjeve
- D) Testet diagnostikuese

Pyetja 2

Testet e përgatitura nga mësuesi, që ndryshe quhen edhe teste të pastandartizuara, nuk kanë për qëllim të:

- A) Motivojnë të nxënët për çështje të përgjithshme dhe të veçanta
- B) Sigurojnë informacion për përvojat emotive-afektive të nxënësve
- C) Sigurojnë një informacion për qëllim raportimi
- D) Masin përparimin e nxënësve në lidhje me objektivat specifike

Pyetja 3

Shkalla e suksesit të mësuesit në kryerjen e mësimit dhe të detyrave të tjera të përcaktuara në kontratë dhe të kërkuara nga natyra e punës së tij, ka të bëjë me:

- A) Vetëpërmbytjen e mësuesit
- B) Përgatitjen e tij profesionale
- C) Përgatitjen e tij pedagogjike
- D) Efektivitetin e mësuesit

Pyetja 4

Komponentët më të rëndësishëm të vlerësimit kur vlerësojmë mësuesin janë:

- A) Kompetencat e tij analitiko-përshkruese
- B) Kompetencat e tij interpretuese dhe kritike
- C) Kompetencat e tij krijuese
- D) Kompetencat gjatë mësimit që zhvillon

Pyetja 5

Mbikqyrja si një dukuri bihevioriste, teknike ose racionale, është sipas pikëpamjes:

- A) Pozitiviste
- B) Fenomenologjike
- C) Teorisë kritike
- D) Pragmatike

Pyetja 6

Vlerësimi i mësuesit realizohet nëpërmjet një sërë mënyrash, ku më kryesorja është:

- A) Mbikqyrja
- B) Konsultimi
- C) Këshillimi
- D) Rekomandimi

Pyetja 7

Mbikqyrja si një dukuri që reflekton interesimin humanist është sipas:

- A) Pikëpamjes pozitiviste
- B) Pikëpamjes fenomenologjike
- C) Teorisë kritike
- D) Pikëpamjes pragmatike

Pyetja 8

Procesi, gjatë të cilit realizohen gjykime për veten ose për disa karakteristika të vetes, quhet:

- A) Analizë
- B) Reflektim
- C) Vetëvlerësim
- D) Vetëgjykim

Pyetja 9

Procesi i analizës kritike i mësuesit ndaj mësimdhënies, që përfshin si elementin njohës edhe atë afektiv, cilësohet si:

- A) Analiza e mësimdhënies
- B) Reflektimi ndaj mësimdhënies
- C) Vetëvlerësimi për mësimdhënien
- D) Vetëgjykimi për metodat e përdorura

Pyetja 10

Testet e shpejtësisë dhe testet e fuqisë kanë të përbashkët faktorin e:

- A) Përgjigjes ndaj kërkesave
- B) Vështirësisë së pyetjeve
- C) Kohës së papërcaktuar
- D) Lehtësisë së pyetjeve

Pyetja 11

Për të kryer vlerësimin e mësuesit dhe të mësimdhënies nuk përdoren:

- A) Vëzhgimet në klasë dhe rezultatet e testimeve e të provimeve
- B) Mbikqyrjet klinike dhe dosja e mësuesit
- C) Dosjet me punimet më të mira të nxënësve
- D) Vlerësimet nga kolegët, nxënësit dhe prindërit

Pyetja 12

Vëzhgimet në klasë, që përbëjnë edhe mënyrën më natyrale për vlerësimin e mësuesit, mund të jenë:

- A) Të strukturuara dhe të improvizuara
- B) Të paplanifikuara ose të planifikuara
- C) Të strukturuara ose të pastrukturura
- D) Të improvizuara dhe të paplanifikuara

Pyetja 13

Elementë të tillë për vlerësimin e mësuesit si: një takim paraprak, vëzhgimi i mësimdhënies në klasë, analiza e të dhënave të vëzhguara dhe një takim i shkurtër pas vëzhgimit janë parametra të:

- A) Mbikqyrjes klinike
- B) Vëzhgimit të strukturuar
- C) Vëzhgimit të pastrukturuar
- D) Këshillimit

Pyetja 14

Vlerësimi i mësuesit, i cili realizohet me anë të vëzhgimit të disa orëve të mësimit, nga një inspektor apo administrator i cili plotëson pikët në një formular standart që përmban listën e kriterëve për efektshmërinë e veprimtarisë së mësuesit në klasë:

- A) Jep gjithë informacionin e nevojshëm që duhet për vlerësimin e mësuesit
- B) Siguron informacion për procesin e planifikimit të mësimit
- C) Jep të dhëna se si mësuesi punon me kolegët, me nxënësit dhe me prindërit
- D) Nuk jep gjithë informacionin e nevojshëm që duhet për vlerësimin e mësuesit

Pyetja 15

Elementët e tillë për vlerësimin e mësuesit si: hapi paravlerësues, vëzhgimi në klasë, intervista vlerësuese dhe veprimi konkret janë elementë të vlerësimit:

- A) Nga ana e administratorit ose inspektorit
- B) Nga ana e drejtuesit të institucionit arsimor
- C) Nga ana e prindërve apo e nxënësve
- D) Nga ana e një kolegu në shkollë

Pyetja 16

Mësimet e regjistruara nga ana e mësuesit janë një burim shumë i vlefshëm për:

- A) Plotësimin e dosjes së mësuesit
- B) Vetëanalizën nga ana e mësuesit
- C) Zhvillimin e kompetencave krijuese të mësuesit
- D) Zhvillimin e kompetencave analitike dhe përkrahëse të mësuesit

Pyetja 17

Testet objektive nuk përdoren në matjen e:

- A) Personalitetit
- B) Inteligjencës
- C) Shpejtësisë
- D) Arritjeve

Pyetja 18

Kur flasim për efektshmërinë e mësuesit gjatë realizimit të punës së tij nuk diskutojmë për:

- A) Aftësinë e mësuesit për të realizuar një lidhje midis interesave të nxënësve me përmbajtjen e lëndës së dhënë mësimore.
- B) Aftësinë e mësuesit për të lidhur veprimtarinë e nxënësit me procesin e zhvillimit të tij
- C) Zhvillimin e tij afektiv dhe relational në përgjithësi
- D) Sjelljen e mësuesit në klasë në lidhje me grupin

Pyetja 19

Procesi, të cilin e zhvillon mësuesi dhe që ka të bëjë me hartimin e evidencave se në çfarë niveli përparimi është klasa, si ndahen nxënësit për nga niveli i përparimit etj, ka të bëjë me:

- A) Hartimin e evidencave për takimin me prindër
- B) Plotësimin e karakteristikave të sjelljes së nxënësve
- C) Vetëvlerësimin e plotë të mësimdhënies
- D) Plotësimin e evidencave përfundimtare për nxjerrjen e notave

Pyetja 20

Procesin e grumbullimit dhe të organizimit të rregullt të informacionit mësimor dhe edukativ do ta quajmë:

- A) Vlerësim në arsim
- B) Gjykim në arsim
- C) Matje në arsim
- D) Parashikim në arsim

Pyetja 21

Testet objektive të tipit plotësues kanë të përbashkët me testet objektive të tipit përzgjedhës faktin që përdoren gjerësisht për matjen e:

- A) Inteligjencës, arritjeve dhe aftësive të nxënësve
- B) Shkëmbimeve sociale, afektive dhe relacionale të nxënësve
- C) Përvojave ndijore dhe perceptive të nxënësve
- D) Funksioneve eksploruese, konstruktive dhe komunikative të nxënësve

Pyetja 22

Testet me alternative të shumta, si një lloj i testeve objektive, synojnë të mundësojnë matjen në nivelet e:

- A) Sintezës dhe vlerësimin
- B) Zbatimit dhe analizës
- C) Njohjes dhe zbatimit
- D) Kuptimit dhe analizës

Pyetja 23

Vlerësimi i cili përcakton arritjet në përfundim të kapitullit, apo të vitit akademik për të vendosur notat, është vlerësimi:

- A) Vlerësim i jashtëm
- B) Vlerësim i brëndshëm
- C) Përmbledhës
- D) Objektiv

Pyetja 24

Për fëmijët e moshës parashkollore përdoren testet:

- A) Subjektive
- B) Verbale

- C) Joverbale
- D) E shpejtësisë

Pyetja 25

Testet me përgjigje të shkurtra dhe me plotësim janë teste:

- A) Objektive
- B) Subjektive
- C) Joverbale
- D) Ese

Pyetja 26

Testet të cilat janë të bazuara në normë dhe që testojnë aftësi të përgjithshme të nxënësve janë teste:

- A) Formuese
- B) Të shpejtësisë
- C) Diagnostikuese
- D) Të standartizuara

Pyetja 27

Mjeti vlerësues i cili përdoret kur mësuesit i duhet të bëjë një dallim të imët midis nxënësve është:

- A) Buletini i diskutimit
- B) Shkalla vlerësuese
- C) Listëkontrolli
- D) Dëshmia anektodike

Pyetja 28

Një mjet, i cili mund të përdoret për të treguar modele të punës së nxënësit, të cilat dëshmojnë përparimin e nxënësit, aftësitë e tij dhe nivelin e punimeve, është edhe:

- A) Fletorja e detyrave të shtëpisë
- B) Stenda e klasës
- C) Dosja e nxënësit
- D) Fletorja e detyrave të kontrollit

Pyetja 29

Testi që ndihmon mësuesin të përcaktojë se çfarë dinë nxënësit dhe që është një test formues mbi matjen e njohurive, të gatishmërisë dhe të aftësisë të nxënësve, është:

- A) Testi diagnostikues i standartizuar
- B) Testi përmbledhës në fund të kapitullit
- C) Testi ese në fund të vitit akademik
- D) Paratesti para fillimit të mësimin

Pyetja 30

Përdorimi i metodave analitike dhe globale përdoren për vlerësimin e testeve:

- A) Subjektive
- B) Objektive
- C) Të standartizuara
- D) Të njohurive

Pyetja 31

Procesi i cili bazohet në grumbullimin sistematik të të dhënave dhe rezulton në një informacion tepër objektiv është:

- A) Vlerësimi
- B) Gjykimi
- C) Përshkrimi
- D) Analiza

Pyetja 32

Procesi, i cili përmban përshkrimin sasior dhe cilësor si dhe gjykimin për vlerat, është:

- A) Standarti
- B) Vlerësimi
- C) Matja
- D) Përshkrimi

Pyetja 33

Nëse vlerësimi bazohet në matjen objektive, të saktë, të vlefshme dhe të besueshme, atëherë ai është:

- A) Etik
- B) I vlefshëm
- C) I qëndrueshëm
- D) I vërtetë

Pyetja 34

Vlerësimi dhe kërkimi kanë një tipar kryesor të përbashkët i cili është:

- A) Motivimi
- B) Hulumtimi
- C) Përgjithësimi
- D) Strukturimi

Pyetja 35

Nëse kërkimi nuk mund të përgjithsohet dhe të përdoret në një shkallë të gjërë atëherë ai:

- A) Ka vlera shumë të pakta
- B) Ka vlera të konsiderueshme
- C) Nuk ka fare vlera
- D) Ka vlera të shumta

Pyetja 36

Para fillimit të procesit mësimor, mësuesit e kryejnë vlerësimin për të njohur:

- A) Kompetencat analitike dhe përshkruese të nxënësve
- B) Zhvillimin motor, afektiv dhe relational të nxënësve
- C) Karakteristikat, nevojat dhe aftësitë e nxënësve
- D) Zhvillimin konjitiv të nxënësve

Pyetja 37

Koncepti i “moshës mendore” për herë të parë është futur gjatë epokës së:

- A) Reformës
- B) Profesionalizmit
- C) Ekspansionit
- D) Efiçencës dhe Testimit

Pyetja 38

Duke qënë se, vlerësimi është një çështje e rëndësishme e politikës publike, sepse ai vazhdon të luajë një rol shumë të madh në jetën e përditshme, në arsim dhe në punësim, atëherë themi që, interesimi i publikut për vlerësimin është:

- A) Gjithmonë dhe më tepër në rritje
- B) Gjithmonë dhe më tepër në ulje
- C) I pandryshueshëm për një kohë të gjatë
- D) I ndryshueshëm sipas rrethanave të caktuara

Pyetja 39

Përdorimi i gjërë dhe i vazhdueshëm i testeve dhe i vlerësimeve:

- A) Nuk shkakton stres të vazhdueshëm
- B) Shkakton stres të vazhdueshëm
- C) Mund të shkaktojë stres
- D) Shkakton vetëm ankth

Pyetja 40

Mungesa e njohjes së avantazheve dhe disavantazheve të testeve dhe të instrumenatve të tjerë matës, mungesa e njohjes së përparësive dhe të kufizimeve të vlerësimit:

- A) Është një proces i cili tashmë është i ezauruar në sistemin arsimor
- B) Nuk krijon probleme në ecurinë e vlerësimit arsimor
- C) Krijon një mjaft probleme në ecurinë e vlerësimit arsimor

D) Krijojnë probleme që nuk kanë të bëjnë me sistemin arsimor

Pyetja 41

Synimet e përgjithshme afatgjata që duam të arrijmë në të ardhmen janë:

- A) Qëllimet arsimore
- B) Objektivat arsimorë
- C) Objektivat mësimorë
- D) Synimet

Pyetja 42

Taksonomia e objektivave mësimorë më e njohur dhe më e përdorshme që përdorim sot është taksonomia e:

- A) Gagne-s
- B) Hogben-it
- C) Ebel-it
- D) Bloom-it

Pyetja 43

Nxënësit i mësojnë strategjitë për suksesin në klasë sapo ata provojnë disa nga proceduarat e mësuesit për procesin e:

- A) Planifikimit
- B) Vlerësimit
- C) Eksperimentimit
- D) Demonstrimit

Pyetja 44

Gjatë procesit të mësimdhënies dhe të të nxënësve në klasë mësuesi nuk mat:

- A) Nivelin e të vepruarit të nxënësve sipas një plani
- B) Nivelin e gjithë sjelljeve të shfaqura të nxënësit
- C) Nivelin e të kuptuarit nga ana e nxënësit
- D) Nivelin e sjelljes së drejtpërdrejtë të nxënësit

Pyetja 45

Mësuesi ndër njohuritë e tjera, është e domosdoshme që të ketë edhe njohuri të plota për sjelljen atipike ose simptomat e shmangies nga sjellja normale për të realizuar në mënyrë sa më të efektshme procesin e:

- A) Kuptimit të prirjeve që kanë nxënësit
- B) Matjes dhe vlerësimit të nxënësve
- C) Trajtimit të grupeve gjinore që ka klasa
- D) Moderimit të sjelljeve të nxënësve

Pyetja 46

Objektivat e fushës afektive, që formulohen për interesimin e nxënësve ndaj ngacmuesit, bëjnë pjesë në kategorinë e:

- A) Pranimit
- B) Organizimit
- C) Nxjerrjes së vlerave
- D) Përgjigjes

Pyetja 47

Kur mësuesi formulon objektivat mësimorë, ai duhet t'i formulojë si arritje të:

- A) Drejtuesit
- B) Mësuesit
- C) Nxënësit
- D) Nxënësit dhe mësuesit

Pyetja 48

Objektivat e fushës psikomotore, që synojnë aftësitë e përsosura në sajë të të cilave nxënësit mund të krijojnë produkte të reja, bëjnë pjesë në nivelin e:

- A) Familjarizimit
- B) Përshtatjes
- C) Zhvillimit
- D) Perfeksionimit

Pyetja 49

Tetstet të cilat nuk përdorin asnjëherë udhëzimin me shkrim, por përdorin udhëzimet me gojë janë tetstet:

- A) Verbale
- B) Joverbale
- C) Objektive
- D) Subjektive

Pyetja 50

Sistemi i pyetjeve, kërkesave, detyrave të lidhura logjikisht ndërmjet tyre, të cilat kanë të bëjnë me një fushë të caktuar që duhen zgjidhur quhet:

- A) Provim
- B) Projekt
- C) Test
- D) Detyrë kursi

Pyetja 51

Procesi i gjykimit të meritave dhe të arritjeve në bazë të një standarti ose kriteri të caktuar quhet:

- A) Analizë
- B) Argumentim
- C) Vlerësim
- D) Zbatim

Pyetja 52

Vlerësimi i mësuesit është procesi i përshkrimit dhe gjykimit të meritave dhe të vlerave të mësuesit mbi bazën e njohurive, të aftësive, të sjelljes dhe të:

- A) Rezultateve të mësimdhënies
- B) Korrektesës së tij në detyrë
- C) Disiplinës së tij në punë
- D) Saktësisë shkencore dhe pedagogjike

Pyetja 53

Vlerësimi, vetëvlerësimi dhe reflektimi janë procese që shoqërojnë jetën dhe veprimtarinë e:

- A) Mësuesve dhe drejtuesit të shkollës
- B) Mësuesve dhe të nxënësve
- C) Nxënësve dhe të prindërve
- D) Mësuesit dhe të shkollës

Pyetja 54

Procesi, i cili përmbledh analizën e hartimit të planit ditari, të përcaktimit të objektivave, të diagnostikimit të nevojave të nxënësve, të parashikimit të kohës mësimore dhe të krijimit të kushteve për mësim, ka të bëjë me:

- A) Analizën e mësimit
- B) Analizën e metodave të mësimdhënies
- C) Analizën e përparimit të nxënësve
- D) Vetëanalizën e planifikimit të mësimdhënies

Pyetja 55

Vlerësimi i cili synon të zbulojë shkaqet njohëse, fizike, emocionale, shoqërore të problemeve që kanë nxënësit, në mënyrë që të përcaktohen teknikat korrigjuese, është vlerësimi:

- A) Diagnostikues
- B) Formues
- C) Përmbledhës
- D) Objektiv

Pyetja 56

Procesi i vlerësimit të nxënësve nuk përdoret për qëllime:

- A) Mësimore

- B) Joetike
- C) Administrative
- D) Të politikës arsimore

Pyetja 57

Për hartimin e testeve me alternativa të shumta duhet të shkruhen pyetje për të cilat:

- A) Nuk ekziston një përgjigje e caktuar
- B) Ka disa përgjigje të përaftërta
- C) Ekziston një përgjigje e vetme dhe e saktë
- D) Ka disa përgjigje të mundshme

Pyetja 58

Testet, të cilat përdoren për nxitjen dhe përsosjen e të shkruarit si një nga mënyrat për të zhvilluar të menduarit, janë edhe testet:

- A) Objektive
- B) Të përgatitura nga mësuesi
- C) E arritjeve
- D) Subjektive

Pyetja 59

Testet me përgjigje të shkurtra dhe me pohim nuk masin aftësi të:

- A) Interpretimit të të dhënave
- B) Gjikimit të një situatë problemore
- C) Zbatimit të rregullave
- D) Manipulimit të simboleve

Pyetja 60

Nëpërmjet testeve subjektive me përgjigje të kufizuara nuk mund të maten dhe vlerësohen aftësi për të:

- A) Shpjeguar marrëdhëniet shkak-pasojë
- B) Demonstruar përdorim të saktë të procedurës
- C) Paraqitur përkatësinë e argumentave
- D) Formuluar përfundime të vlefshme

Pyetja 61

Karakteristika të tilla si: marrin kohë për t'u vlerësuar apo llogaritja e pikëve nuk është e besueshme, janë:

- A) Kufizime të testeve subjektive
- B) Epërsi të testeve subjektive
- C) Kufizime të testeve objektive
- D) Epërsi të testeve objektive

Pyetja 62

Nëse gjatë procesit të testimit, personi që po testohet shpenzon më shumë kohë për të lexuar dhe për të menduar sesa për të menduar dhe për të shkruar, ky faktor shërben si një dallim midis testeve:

- A) Të standartizuara dhe të pastandardizuara
- B) Individuale dhe testeve të grupit
- C) Objektive dhe subjektive
- D) Joverbal dhe verbale

Pyetja 63

Teknikat dhe instrumentët të cilët ndihmojnë në vrojtimin e drejtpërdrejtë të veprimtarisë së nxënësve dhe përdoren për vlerësim:

- A) Janë shumë të lehtë për tu planifikuar
- B) Janë të vështirë për tu planifikuar
- C) Kanë besueshmëri të konsiderueshme të të dhënave
- D) Mund të përdoren sistematikisht

Pyetja 64

Një teknikë vrojtimi, që mund të përdoret nga mësuesi në klasë për të vrojtuar nxënësit në punën që bëjnë në grupe të vogla ose gjatë diskutimit, është edhe:

- A) Analiza e tipareve semantike
- B) Sistemi ndërveprues i shënimeve
- C) Marrëdhënia pyetje -përgjigje
- D) Buletini i pjesëmarrjes

Pyetja 65

Dëshmia anektodike, që mund të përdoret si teknikë vrojtimi e mësuesit në klasë, nuk përmban:

- A) Informacion identifikues
- B) Datën e vrojtimit
- C) Ndodhi të parëndësishme
- D) Përshkrimin e ndodhisë

Pyetja 66

Në praktikën e përditshme shkollore për qëllime të ndryshme mësimore dhe vlerësimi për nxënësit, nuk përdoret tipi i dosjes:

- A) Aplikuese
- B) Së punës
- C) Dokument
- D) Ekspozuese

Pyetja 67

Punët më të mira dhe të përfunduara të nxënësve depozitohen në:

- A) Dosjen e punës së nxënësit
- B) Dosjen dokument të nxënësit
- C) Dosjen private të nxënësit
- D) Dosjen ekspozuese të nxënësit

Pyetja 68

Aftësi të tilla si: të zotërojë shumë mirë lëndën, të njohë nxënësit, të ketë aftësi të shkruari, të jetë krijues, të dijë të përzgjedhë instrumentin më të mirë, janë aftësi që i duhen mësuesit për të:

- A) Planifikuar mësimdhënien
- B) Shkruar teste të mira
- C) Organizuar mësimdhënien
- D) Shkruar objektiva të mira

Pyetja 69

Grupet e sistemeve të vlerësimit, të cilat praktikohen nga mësuesit në klasë, nuk duhet të:

- A) Jenë subjektive dhe të mbushura me paragjykime
- B) Jenë objektive dhe të çliuara nga paragjykimet
- C) Ndjekin objektivat mësimorë apo ato të vlerësimit
- D) Interpretohen apo të raportohen

Pyetja 70

Përdorimi i notave për të paraqitur rezultatin e arritjeve dhe përparimin akademik të nxënësve:

- A) Nuk ndryshon sipas klasave në të cilat kalon nxënësi
- B) Nuk ka lidhje me klasën në të cilën është nxënësi
- C) Ndryshon sipas klasave paralele të shkollës së mesme të ulët
- D) Ndryshon nga klasat fillore me ato të klasave të tjera të shkollimit

Pyetja 71

Gjatë vlerësimit të testeve subjektive nga ana e mësuesit elementët e të shkruarit zënë një pjesë shumë të rëndësishme dhe:

- A) Duhet të vlerësohen së bashku me përmbajtjen
- B) Duhet të vlerësohen veçantë nga përmbajtja
- C) Nuk duhet të vlerësohen fare
- D) Vetëm ato duhet të vlerësohen

Pyetja 72

Listëkontrolli është një teknikë e cila shërben për të matur:

- A) Performancën gjatë një testi subjektiv

- B) Punën në grup të pjesëmarrësve
- C) Punën individuale të nxënësit
- D) Performancën gjatë një testi objektiv

Pyetja 73

Projektet e nxënësve, janë punime të kryera gjatë një periudhe të caktuar kohe të cilat nuk përfshijnë:

- A) Vlerësimin e të dhënave
- B) Organizimin e të dhënave
- C) Prezantimin e të dhënave
- D) Analizën sasiore të të dhënave

Pyetja 74

Notat nga ana e mësuesit duhet të përdoren:

- A) Vetëm si rezultante të arritjeve akademike
- B) Edhe si rezultante të arritjeve akademike
- C) Si rezultante të arritjeve akademike dhe të sjelljeve
- D) Vetëm si rezultante e sjelljes së nxënësit

Pyetja 75

Mësuesi, për të bërë vlerësimin e punës në grup të nxënësve, nuk merr parasysh elementë të tillë si:

- A) Ndarjen e informacionit me të tjerët dhe ndihmesën në ide
- B) Dëgjimin e të tjerëve dhe ndjekjen e udhëzimeve
- C) Kompetencat analitike individuale të nxënësve
- D) Pranimin dhe kryerjen e detyrave të përcaktuara në grup

Pyetja 76

Cilësia e raportimit periodik formal të prindërve për ecurinë e fëmijëve të tyre nga ana e mësuesve:

- A) Nuk është shumë e rëndësishme për ecurinë e nxënësve
- B) Ka pak rëndësi për procesin e ecurisë së nxënësve
- C) Ka rëndësi për procesin e ecurisë së nxënësve
- D) Ka shumë rëndësi për procesin e ecurisë së nxënësve

PS)

Pyetja 77

Nëse vlerësimi i projektit përqëndrohet te produktet, atëherë ai përdoret nga ana e mësuesit për:

- A) Vlerësimin e vazhdueshëm
- B) Vlerësimin përmbledhës
- C) Vlerësimin e përditshëm
- D) Vlerësimin në proces

Pyetja 78

Formulimi i objektivave të mirë mësimorë:

- A) Nuk luan rol në vlerësimin e arritjeve të nxënësit
- B) Luan rol në vlerësimin e arritjeve të nxënësit
- C) Luan rol shumë të rëndësishëm në vlerësimin e arritjeve të nxënësit
- D) Nuk ka fare lidhje me vlerësimin e arritjeve të nxënësit

Pyetja 79

Mësuesi, kur bën hartimin e objektivave të përgjithshëm mësimorë për testim, duhet t'i përcaktojë ato:

- A) Në terma të matshëm
- B) Në terma jo të matshëm
- C) Sipas rëndësisë së materialit që kontrollon
- D) Sipas cilësisë së materialit që kontrollon

Pyetja 80

Testet subjektive vënë theksin më shumë te:

- A) E veçanta se te e tëra
- B) E tëra se në pjesë të veçanta
- C) Organizimi
- D) Mënyra e të shkruarit

PROGRAMI I PËRBASHKËT PEDAGOGJI

PJESA E PESTË

KAPITULLI I-rë, TË NXËNËT

Pyetja 1

Nga karakteristikat e mëposhtme, cila mbështetet në teorinë konstruktiviste të nxënësit:

- A) Përforsimi strikt i rregullores
- B) Mundësia për nxënësit që të bëjnë zgjedhje
- C) Një mësim i fokusuar tek grupmosha
- D) Të gjitha

Pyetja 2

Të nxënët biheviorist siguron që nxënësit:

- A) Të mësojnë përmes lojës
- B) Të përdorin materiale që ofrojnë mundësi të shumta
- C) Të punojnë së bashku dhe të kujdesen për njëri-tjetrin
- D) Të mësojnë sipas objektivave të paracaktuara nga mësuesi

Pyetja 3

Që mësuesi të krijojë mundësinë e të nxënësve sipas hapave të Ganjesë:

- A) Të marrë gjithë përgjegjësinë mbi vete
- B) Të respektojë mendimet e sugjerimet e nxënësve
- C) Të marrë leje në Drejtorinë e shkollës
- D) Të gjitha

Pyetja 4

Çfarë efektesh negative kanë injorimi i influencave kulturore sipas këndvështrimit konstruktivist të të nxënësve?

- A) Vështirësi komunikimi të grupit të nxënësve
- B) Ngadalëson të nxënësve e të gjithë fëmijëve në klasë
- C) Shton problemet e sjelljes të grupit të marginalizuar
- D) Të gjitha

Pyetja 5

Ç'loj të nxënësve përfshin teoria e Vygotskyt?

- A) Të nxënësve me në qendër drejtorin
- B) Të nxënësve me në qendër shkollën
- C) Të nxënësve me në qendër nxënësve
- D) Të nxënësve me në qendër mësuesin

Pyetja 6

Cila karakteristikë nuk është pjesë e të nxënësve humanist sipas Rogers?

- A) Nxënësve zhvillojnë individualitetet e tyre
- B) Nxënësve ndihen të respektuar nga mësuesi
- C) Prindërit nuk marrin pjesë në procesin mësimor
- D) Të gjitha

Pyetja 7

Të nxënësve shpjegues sipas Ausubelit duhet të përfshijë:

- A) Përdorimin e organizuesve paraprakë
- B) Përcaktimin e rregullave të paracaktuara
- C) Dhënien e shpjegimeve në lidhje me paqartësitë e mundshme
- D) Dhënien e dënimeve nëse nxënësve nuk binden

Pyetja 8

Metodat e komunikimit në klasë sipas këndvështrimit sociokonstruktivist përfshijnë:

- A) Inkurajimin e pjesëmarrjes
- B) Përcaktimin e rregullave nga mësuesi
- C) Pavarësinë nga programi lëndor
- D) Diskutimin e pyetjeve të vështirësisë në rritje

Pyetja 9

Cilat karakteristika NUK mund të gjenden në një klasë ku zhvillohet të nxënëti ndërveprues?

- A) Objektiva e pikësnyime të qarta, realiste e të arritshme
- B) Materiale e aktivitete pa interes për nxënësit
- C) Aktivitete që kënaqin aftësitë, interesat dhe përjetimet e ndryshme të fëmijëve
- D) Përjetime aktive që angazhojnë tërësisht fëmijët

Pyetja 10

Ndryshimet e sugjeruara të organizimit të klasës për të lejuar mësimnxënien sociokognitive përfshijnë:

- A) Objektiva e pikësnyime të qarta, realiste e të arritshme
- B) Materiale me interes të lartë për nxënësit
- C) Aktivitete që kënaqin aftësitë, interesat dhe përjetimet e ndryshme të fëmijëve
- D) Të gjitha

Pyetja 11

Cila nga teknikat e mëposhtme të të nxënëtit mund të përdoret më shpesh në një klasë që nxit të nxënëti konstruktivist?

- A) Të nxënëti me bashkëpunim
- B) Lektrimi nga ana e mësuesit
- C) Rregullat strikte të përcaktuar nga drejtorja
- D) Marrja e shënimeve nga dërrasa e zezë

Pyetja 12

Bledi është një mësues rishtar në gjeografi. Ai po mbikqyr grupe të vogla nxënësish të klasës së gjashtë, që po punojnë së bashku në hartën memecë. Ai vë re me kënaqësi që pothuajse të gjithë duken të interesuar në punë. Ai i kërkon të heshtin vetëm dy djemve në një cep të klasës që janë përfshirë në një diskutim të gjallë. Duke aplikuar gjetjet e studimit të Housner dhe Griffey, si do t'i vlerësonit veprimet e Bledit?

- A) Ka të drejtë të fokusohet në interesat e nxënësve, pasi ky është një tregues i fuqishëm i performancës së tyre
- B) Ka të drejtë të fokusohet në interesat e nxënësve, por duhet t'u japë më shumë përforsime pozitive nxënësve që tregojnë përgjigjet e sakta
- C) Duhet të fokusohet më pak në interesat e nxënësve dhe më shumë në atë që nxënësit po i mësojnë saktë konceptet
- D) Duhet të fokusohet më pak në interesat e nxënësve dhe të mbikqyrë më pak, në mënyrë që nxënësit të zhvillojnë pavarësi në të nxënë

Pyetja 13

Nëse një mësues ka planifikuar kohë që nxënësit të punojnë në klasë me ushtrimet e matematikës dhe nxënësit duken se janë të përfshirë në detyrë, kjo do të quhej:

- A) Të nxënësit e planifikuar
- B) Të nxënësit në detyrë
- C) Të nxënësit e nevojshëm
- D) Të nxënësit akademik

Pyetja 14

Modelet racionale lineare që planifikojnë të nxënësit bihevorist mund të paraqiten sipas cilit diagram:

- A) veprimet → arritjet → qëllimet
- B) qëllimet → veprimet → arritjet
- C) arritjet → qëllimet → veprimet
- D) qëllimet → arritjet → veprimet

Pyetja 15

Cila nga pohimet e mëposhtme duket se është një pasojë negative e planifikimit sipas modelit bihevorist?

Mësuesit bëhen...

- A) Më pak të ndjeshëm ndaj ideve të nxënësve
- B) Më të ndjeshëm ndaj ideve të nxënësve
- C) Më pak krijues në mësimdhënie

D) Më pak të interesuar mbi lëndën

Pyetja 16

Në planifikimin e aktiviteteve për përcaktimin e rutinës sipas qasjes socio-kognitiviste, mësuesi duhet të:

- A) shkruajë detajet e rutinës, si të folurit me leje apo mbledhjen e detyrave të shtëpisë
- B) konsiderojë interesat e nxënësve në planifikimin më të mirë të të nxënësve
- C) përcaktojë materialet që i duhen për të realizuar të nxënësve të suksesshëm
- D) identifikojë grupet e nxënësve me vështirësi në të nxënësve

Pyetja 17

Modelet e planifikimit jolinear për të mundësuar të nxënësve konstruktivist mund të paraqiten sipas cilit diagram:

- A) veprimet → arritjet → qëllimet
- B) qëllimet → veprimet → arritjet
- C) arritjet → qëllimet → veprimet
- D) qëllimet → arritjet → veprimet

Pyetja 18

Cila nga pohimet e mëposhtme duket se është një pasojë pozitive e planifikimit të mësuesve për të nxitur të nxënësve bihevorist të nxënësve?

Planifikimi i mësuesit tenton të eliminojë....

- A) Mërzitjen e nxënësve
- B) Shumë probleme menaxhimi
- C) Disiplinimin e nxënësve
- D) Dështimin e nxënësve

Pyetja 19

Cila nga pohimet e mëposhtme *nuk* është përbërës i përshtatshëm për një objektiv të nxëni kognitivist?

- A) Është i bazuar mbi nxënësin
- B) Është i ndryshueshëm
- C) Përcakton situatën e testimit
- D) Përshkruan kriteret e performancës

Pyetja 20

Cila nga të mëposhtmet është një shembull i një aktiviteti klase i planifikuar qëllimisht për të ndërtuar bashkërendimin e grupit të nxënësve për një të nxënë konstruktivist?

- A) Një mësim javor mbi ngjarjet aktuale
- B) Një takim javor mbi progresin e klasës
- C) Listimi i objektivave javore në dërrasë të zezë
- D) Listimi i aktiviteteve javore në dërrasë të zezë

Pyetja 21

Dimensioni i njohurive në taksonominë e rishikuar të Bloom ka katër kategori. Cila nga kategoritë e mëposhtme *nuk* bën pjesë në këto kategori?

- A) Faktike
- B) Metakognitive
- C) Analitike
- D) Konceptuale

Pyetja 22

Cili motiv njerëzor plotësohet kur mësuesit ndihmojnë nxënësit të punojnë drejt qëllimeve sfiduese por të arritshme sipas këndvështrimit humanist të Maslout?

- A) Arritja
- B) Influenca
- C) Përkatësia
- D) Sqarimi

Pyetja 23

Lexoni transkriptin e mëposhtëm të orës së edukimit qytetar në klasë të nëntë:

Mësuesi: Sandra, cili ishte lajmi kryesor në gazetë sot?

Sandra: Ishte për Parlamentin, që aprovonte emërimin e Presidentit për Avokatin e Shtetit.

M: Cili është vlerësimi yt për kualifikimet e kandidatit?

S: Epo, ai duket se ka pak eksperiencë në juridik dhe më shumë duket se ka status politik, që nuk më duket vendimi më i mirë për vendin.

M: Cilat ishin veprimet apo thëniet e kandidatit që të shtynë të arrish këtë konkluzion?

Në bazë të këtij transkripti cilat nga pohimet e mëposhtme ka më shumë gjasa të jetë i vërtetë mbi qëllimet që ka mësuesi për të nxënësit sipas këndvështrimit kognitiv?

- A) Ky është një mësim i paplanifikuar, i sajuar në moment
- B) Ky mësues ka planifikuar në mënyrë rigoroze objektivat specifike të përmbajtjes, mbi të cilët fokusohet mësimdhënia e tij
- C) Ky mësues mund të ketë planifikuar qëllimet e arritjes së nxënësve dhe stilin e mësimdhënies, por është në gjendje t'i përgjigjet ideve të nxënësit
- D) Ky mësues ka planifikuar tej mase dhe nuk është i kujdesshëm ndaj ideve të nxënësit

Pyetja 24

Mira, një mësuese e klasës së tretë, po punon mbi planin e lëndës “Të njohim vendlindjen”. Ajo ka vendosur, duke u bazuar në udhëzimet e Drejtorisë Arsimore Rajonale, që përmbajtja duhet të jetë mbi kulturën në Tiranë dhe ajo do të ngulë këmbë në mënyrë të veçantë mbi faktin se në Tiranë jetojnë njerëz me prejardhje të ndryshme, si pjesë e bukurisë së njohjes së kulturave të prejardhjes. Ajo po përgatitet duke detajuar teknikat motivacionale që do të përdorë dhe hapat e aktiviteteve specifike që do të ndjekë. Sipas studimit të Yinger, ç’lloj të nxëni po inkurajon Mira?

- A) Socio-konstruktivist
- B) Biheviolist
- C) Humanist
- D) Kognitivist

Pyetja 25

Nga lista e mëposhtme, zgjidhni procesin që *nuk* është i përfshirë në fushën kognitive të Taksonomisë së rishikuar të Bloom :

- A) Kuptoj
- B) Mbaj mend
- C) Aplikoj
- D) Vlerësoj

Pyetja 26

Mësues Bashkimi po planifikon për javën në vazhdim. Ai sigurohet që të përcaktojë kohën për diskutim në grup të madh, punë me grupe, detyra të pavarura dhe detyra në kompjuter. Sipas teorive të të nxënësve, Mësues Bashkimi synon:

- A) Që nxënësit të nxënë në mënyrë të sekuencuar
- B) Që nxënësit të nxënë në mënyrë të larmishme
- C) Që nxënësit të mësojnë në mënyrë rutinë
- D) Që nxënësit të mësojnë sipas interesave individuale

Pyetja 27

Mësuese Bardha po planifikon një njësi hyrëse të rubrikës “Të shkruajmë” për nxënësit e klasës së katërt. Programi kombëtar kërkon që nxënësit të aftësohen në dymbëdhjetë standarde sa i përket të shkruarit. Mësuesja ka dhe disa qëllime që mendon se janë thelbësore. Por ajo zgjedh të punojë vetëm me programin kombëtar. Duke patur parasysh studimin e Duchastel dhe Brown, çfarë parashikoni se do të jenë efektet mbi të nxënësit e nxënësve?

- A) Nxënësit do të kenë arritje më të mira në të dyja grupet e qëllimeve
- B) Nxënësit do të kenë arritje më të mira në qëllimet e mësueses dhe arritje më të dobëta në standardet kombëtare
- C) Nxënësit do të kenë arritje më të mira në standardet kombëtare dhe më të dobëta në qëllimet e mësueses
- D) Nuk do të ketë efekt në arritjet e nxënësve

Pyetja 28

Sipas kërkimit të Housner dhe Griffey cili nga pohimet e mëposhtme përshkruan më mirë mënyrën si planifikojnë mësuesit rishtarë dhe ata me përvojë për të nxitur të nxënët kognitiv tek nxënësit e klasës së tyre?

- A) Mësuesit me përvojë kanë tendencën të harxhojnë më shumë kohë për të planifikuar si të japin udhëzimet me gojë, ndërkohë që mësuesit rishtarë fokusohen në mënyrat si të vlerësojnë të nxënët e nxënësve dhe t'u japin feedback
- B) Mësuesit rishtarë kanë tendencën të harxhojnë më shumë kohë për të planifikuar si të japin udhëzimet me gojë, ndërkohë që mësuesit me eksperiencë fokusohen në mënyrat si të vlerësojnë të nxënët e nxënësve dhe t'u japin feedback
- C) Mësuesit me eksperiencë kanë tendencën të harxhojnë më shumë kohë për të menduar si të përdorin kohën, sesa mësuesit rishtarë
- D) Mësuesit rishtarë kanë tendencën të mendojnë më pak mbi menaxhimin e klasës ku planifikojnë sesa mësuesit me përvojë

Pyetja 29

Nga lista e mëposhtme, zgjidhni procesin që nuk është i përfshirë në taksonominë afektive të Bloom.

- A) Sinteza
- B) Dhënia vlerë
- C) Organizimi
- D) Marrja

Pyetja 30

Mësuese Elma mësim me nxënësit e klasës së gjashtë. Gjatë orës së mësimin, drejtori vjen për të zgjedhur pjesëmarrësit në një konkurs dhe harxhon 12 minuta. Minutat që mbetën ç'mund të jenë?

- A) Kohë reale të nxëni
- B) Kohë e impenjuar të nxëni
- C) Kohë e alokuar të nxëni
- D) Kohë e planifikuar të nxëni

Pyetja 31

Që nxënësit të kenë një proces më efikas të nxënit sipas Kirshenbaum ...

- A) Nxënësit duhet të jenë në të njëjtën moshë zhvillimore
- B) Klasa duhet të jetë e organizuar me rreshta
- C) Nxënësit duhet të veshin uniformë
- D) Klasa duhet të ketë ngjyra te qeta

Pyetja 32

Që klasa të inkurajojë të nxënësit sipas Schunk ...

- A) Mjedisi duhet të përdoret nga dy grupe nxënësish
- B) Në mure nuk duhet të ketë punime të fëmijëve
- C) Klasa duhet të ketë ndriçim të mjaftueshëm natyral
- D) Të gjitha

Pyetja 33

Antecedentët që mund të çojnë në sjellje të papranueshme të një nxënësi sipas bihejoristëve nuk mund të jenë:

- A) Për shkaqe fizike
- B) Për shkak të marrëdhënieve me individë të tjerë
- C) Për shkaqe kulturore
- D) Për shkaqe të nënvetëdijes

Pyetja 34

Të folurit në një klasë mbështet të nxënësit konstruktivist

- A) Është i larmishëm dhe pranon dhe përdorim të dialektalizmave
- B) Është zyrtar dhe i mbështetur tek teksti
- C) Bëhet vetëm me leje të mësuesit
- D) Të gjitha

Pyetja 35

Që klasa të mund të inkurajohet të nxënësit sipas modelit bihejorist ...

- A) Rregullat janë të shkruara qartësisht në dosjen e mësuesit
- B) Rregullat janë për përdorim profesional të mësuesit
- C) Rregullat mund të jenë të shoqëruara me ilustrime për fëmijët e shkollës fillore
- D) Të gjitha

Pyetja 36

Çfarë efektsh kanë injorimi i influencave kulturore në aftësinë dhe gatishmërinë e nxënësve për të mësuar sipas teorisë social konstruktiviste?

- A) Ul cilësinë e komunikimit
- B) Ngadalëson të nxënësit
- C) Shton problemet e sjelljes

D) Të gjitha

Pyetja 37

Maria, një mësuese e klasës së parë u ka dhënë nxënësve letra bixhozi për të luajtur, me qëllim që të përsërisin veprimet e mbledhjes. Qasja e Maries mbështetet nga:

- A) Humanizmi
- B) Socio-kognitivizmi
- C) Bihevizorizmi
- D) Kognitivizmi

Pyetja 38

Në një klasë që përdor shpesh të nxënët socio-konstruktivist ...

- A) Mësuesit e dinë që fëmijët zhvillohen në mënyrë të veçantë, kanë stadet e tyre kohore, si dhe nevojat e tyre individuale
- B) Të mësuarit është një proces i vazhdueshëm
- C) Mësuesit vlerësojnë idetë dhe informacionin që marrin nga prindërit
- D) Të gjitha

Pyetja 39

Sipas bihevizoristëve, sjelljet e papërshtatshme nuk lindin

- A) Nga pjesëmarrja në aktivitete në grup
- B) Nga një dëshirë e brendshme për t'u grindur
- C) Nga interpretimet vetiake të individit lidhur me eksperiencat e tij të grumbulluara
- D) Nga vlerat e familjes

Pyetja 40

Që klasa të mund të inkurajojë të nxënët sipas këndvështrimit kognitivist ...

- A) Mjedisi duhet të pengojë shkëputjen e vëmendjes
- B) Ambjenti krijon hapësirë për të vepruar lirshëm
- C) Fëmijët duhet të kenë rrugëkalimi të lirshëm për të mos penguar të tjerët
- D) Të gjitha

Pyetja 41

Nxënësit e mësuese Pranverës e dinë se nëse arrijnë t'i përgjigjen saktë të gjitha pyetjeve të minitestit nuk do të marrin detyra shtëpie për atë lëndë. Mësuese Pranvera po përdor:

- A) Përforcimin pozitiv
- B) Përforcimin negativ
- C) Ndëshkimin
- D) Injorimin

Pyetja 42

Një nxënës nuk po përqendrohej në procesin mësimor. Mësuese Besa i jep një paralajmërim, siç është vendosur në rregullat e klasës. Mësuese Besa po përdor cilin përforcues negativ:

- A) Izolimin shoqëror
- B) Qortimin
- C) Humbjen
- D) Asnjërën

Pyetja 43

Sipas cilës teori njohuritë ndërtohen nga vetë nxënësi nëpërmjet proceseve të brendshme, si organizimi, përvetësimi dhe përshtatja?

- A) Humanizmi
- B) Socio-kognitivizmi
- C) Bihevizmi
- D) Kognitivizmi

Pyetja 44

Për mësimin mbi ujin, mësues Dritani ka vendosur t'i organizojë nxënësit në grupe që bëhen "ekspertë" në fusha specifike, si uji dhe mjedisi, uji si nevojë shoqërore, shpërndarja gjeografike e ujit etj. Më pas "ekspertët" do të rigrupohen dhe do t'i mësojnë shokëve të tyre mbi çështjen në të cilën u fokusuan. Mësues Dritani po përdor çfarë teknike të nxëni konstruktivist?

- A) Pyetje të ndërsjellta
- B) Debati i strukturuar
- C) Rebusi
- D) Lojë me role

Pyetja 45

Nëse një nxënës që ka mendim pozitiv për efikasitetin e tij dhe nuk arrin rezultat të mirë, ai nuk ia atribuon dështimin:

- A) Mungesës së përpjekjeve
- B) Mungesës së aftësisë
- C) Moskuptimit të udhëzimeve
- D) Studimit të pamjaftueshëm

Pyetja 46

Nxënësit po dorëzojnë detyrat e klasës. Mësuesja thotë: “Pasi ta mbaroni, duhet ta kontrolloni të paktën për 1 minutë, ç’ka do të thotë ta shikojmë me kujdes”. Mësuesja po përdor strategji motivimi të të nxënësve:

- A) Që nxënësit të kenë përgjegjësi dhe pritshmëri të lartë
- B) Që nxënësit të bëjnë lidhje me programet e lëndëve të tjera
- C) Që nxënësit t’i tërhiqet vëmendja në privatësi
- D) Që nxënësit të zhvillojnë mendimin kritik

Pyetja 47

Nëse një nxënës përdor figurat për të mbajtur mend mësimin, ai është duke përdorur:

- A) Kujtesën procedurale
- B) Kujtesën episodike
- C) Kujtesën imazherike
- D) Kujtesën implicite

Pyetja 48

Nëse i mësojmë nxënësve teknika kognitive për të mësuar përmendësh, jemi duke i ndihmuar të mësojnë:

- A) Metodën loci
- B) Metodën zinxhir
- C) Metodën mnemonike
- D) Metodën e fjalëve kyçe

Pyetja 49

Sipas modelit të mësimdhënies që nxit mendimin kritik e krijues, mësuesit duhet të ndjekin këto hapa për organizimin e cikleve mësimorë:

- A) eksplorimi → kërkimi → përdorimi → njohja
- B) njohja → eksplorimi → kërkimi → përdorimi
- C) kërkimi → përdorimi → Njohja → eksplorimi
- D) të gjitha

Pyetja 50

Të nxënësit që ofron mundësinë për të eksploruar aktivisht me të gjitha shqisat për nxënësit e shkollës së mesme të ulët ...

- A) Nuk është i këshilluar: nxënësit janë të rritur tashmë
- B) Nuk është i mundshëm: kemi pak materiale e shumë nxënës
- C) Është fortësisht i inkurajuar, duke qënë mënyra më e mirë e të nxënësve
- D) Të gjitha

PJESA E PESTË

KAPITULLI II-të, MENAXHIMI I KLASËS

Pyetja 1

Mësuesit mund të ndryshojnë sjelljet prolematike me anë të:

- A) Shtimit të përdorimit të metodave ndëshkuese të kontrollit
- B) Mos – kuptimit dhe respektimit të ndryshimeve kulturore/etnike
- C) Përcaktimit të rregullave të qarta për sjelljen e nxënësve
- D) Mos-trajtimin e dështimeve mësimore të nxënësve

Pyetja 2

Mungesa e shprehive të rëndësishme sociale sjellë:

- A) Mos bashkëveprim në mënyrë pozitive me moshatarët
- B) Paafësi për t'u përshtatur ndaj ndryshimeve
- C) Menaxhim i keq i kritikave të të rriturëve dhe ngacmimet

nga moshatarët
D)Të gjitha

Pyetja 3

Monitorimi i klasës gjatë orës së mësimit mund të bëhet duke:

- A) Qëndruar ulur në një vend për një kohë të gjatë
- B) Shpërblyer ose lavdëruar nxënësit që ndjekin rregullat në klasë
- C) Duke mos kontrolluar punën e nxënësve
- D) Monitorojmë sjelljen e nxënësit duke e ndëshkuar

Pyetja 4

Një nga mënyrat kryesore për të mbajtur rregullin në klasë është:

- A) Gjatë hartimit dhe përcaktimit të rregullave që do të ndiqen në klasë, të mos përfshihen nxënësit.
- B) Rregullat duhen përcaktuar në formë negative dhe jo pozitive.
- C) Rregullorja e klasës të komunikohet qartë dhe herët tek nxënësit
- D) Rregullat s'janë të nevojshme të ripërsëriten me intervale të rregullta

Pyetja 5

Cilët nga shembujt e mëposhtëm mund të përdoren si rregulla në klasë:

- A) Të jeni të ulur në bankën tuaj kur të bjerë zilja
- B) Dëgjoni me kujdes
- C) Mos u vononi në klasë
- D) Të jeni të ulur në bankën tuaj kur të bjerë zilja dhe të dëgjoni me kujdes

Pyetja 6

Një përforcues është:

- A) Një objekt ose ndodhi që pason një sjellje të caktuar, që ruan në të njëjtin nivel ose e rrit shpeshtësinë e përsëritjes së kësaj sjellje
- B) Një objekt ose ndodhi që pason një sjellje të caktuar, që nuk sjell asnje ndryshim të ri.
- C) Një objekt ose ndodhi që pason një sjellje të caktuar, që e ul shpeshtësinë e përsëritjes së kësaj sjellje
- D) Një objekt ose ndodhi që pason një sjellje të caktuar, që nuk sjell asnje ndryshim të ri dhe e ul shpeshtësinë e përsëritjes së kësaj sjellje

Pyetja 7

Një ndëshkues është:

- A) Një objekt ose ndodhi që pason një sjellje të caktuar, që ruan në të njëjtin nivel ose e rrit shpeshtësinë e përsëritjes së kësaj sjellje
- B) Një objekt ose ndodhi që pason një sjellje të caktuar dhe pakëson mundësinë e përsëritjes së sjelljes ose ul frekuencën e saj
- C) Një objekt ose ndodhi që pason një sjellje të caktuar, që ruan në të njëjtin nivel ose e rrit shpeshtësinë e përsëritjes së kësaj sjellje dhe rrit frekuencën e kësaj sjellje
- D) Një objekt ose ndodhi që pason një sjellje të caktuar dhe rrit frekuencën e kësaj sjellje

Pyetja 8

Trajtimi i ndryshëm i nxënsëve i ndihmon duke:

- A) I dhënë materiale të ndryshme për të mesuar, të përshtatshme me nivelet e tyre të funksionimit
- B) Trajtuar nxënës që shfaqin sjellje problematike
- C) I trajtuar të gjithë njëllë, efekti mbi sjelljen nuk do të ishte përfituese në mënyrë uniforme
- D) Të gjitha

Pyetja 9

Strategjitë pozitive të menaxhimit të klasës ndikojnë në:

- A) Nënësia përmirëson mendimin për veten
- B) Rrit aktivizimin në klasë
- C) Keqëson qëndrimin ndaj shkollës dhe punës në shkollë
- D) Nënësia përmirëson mendimin për veten dhe rrit aktivizimin në klasë

Pyetja 10

Procedurat ndëshkuese të menaxhimit të klasës ndikojnë në:

- A) Ndalon menjëherë sjelljen
- B) Shkakton tërheqje
- C) Keqëson mendimin për veten
- D) Të gjitha

Pyetja 11

Me anë të shprehjes “Shumë mirë! Ke integruar materialin me shëmbuj përkatës!” Keni përdorur:

- A) Prapaveprim
- B) Përforcues pozitiv
- C) Lavdërim specifik
- D) Procedurë ndëshkuese

Pyetja 12

Çertifikatat dhe shperblimet për arritjet përdoren me sukses për të:

- A) motivuar nxënësin
- B) menazhuar klasën
- C) ndëshkuar nxënësin
- D) reduktuar shkeljet në sjelle

Pyetja 13

Cilat nga aktivitetet e mëposhtme mund të përdoren për të motivuar nxënësit:

- A) Të jetë komandant klase
- B) Të përdorë kompjuterin
- C) Të ulët në tavolinën e mësuesit
- D) Të gjitha

Pyetja 14

Me fenomenin e rastisjeve konkurruese kuptojmë:

- A) Përforcimin e sjelljeve problematike
- B) Përforcimin e dy detyrave të kundërta
- C) Përforcimin e çdo reagimi
- D) Asnjëra

Pyetja 15

Sipas principit të Premarkut sjelljet të cilat nxënësit i bëjnë shpesh

dhe pa asnjë imponim mund të përdoren për të:

- A) Motivuar nxënës specifik
- B) Përforcuar sjelljet me probabilitet të ulët
- C) Për të ndëshkuar nxënësit
- D) Motivuar nxënës specifik dhe për të ndëshkuar nxënësit

Pyetja 16

Tek kategoria e „të dhënit mësim mirë“ dhe motivues, cili nga aktivitetet

e mëposhtme përfshihet:

- A) Përdorë aktivitete të njohura nga nxënësit
- B) Të mos përfshihen gjatë mësimit ilustrime të gjërave që

u interesojnë nxënësve

- C) Inkurajo të marrin pjesë dhe të përgjigjen në mënyrë aktive
- D) Krijë mundësinë që vetëm nxënësit më të talentuar të arrijnë suksesin

Pyetja 17

Kur vleresojmë publikisht bërjen e detyrave të shtëpisë kemi

përdorur strategji e:

- A) modelimit
- B) rasisjeve konkurruese
- C) imitimit
- D) modelimit dhe imitimit

Pyetja 18

Tek avantazhet e përdorimit të strategjisë së modelimit përfshihet:

- A) Mundësia që i jepet nxënësit për të qënë dëshmitarë që sjellja e mirë vlerësohet
- B) Minimizon efektet negative që mund të sjellë ndëshkimi në klasë
- C) Nuk një mjet që funksionon menjëherë
- D) Mundësia që i jepet nxënësit për të qënë dëshmitar që sjellja e mirë vlerësohet dhe minimizimi i efekteve negative që mund të sjellë ndëshkimi në klasë

Pyetja 19

Tek disavantazhet e përdorimit të strategjisë së modelimit përfshihet:

- A) Mësuesit “harrojnë“ të vënë në dukje dhe të vlerësojnë aktin e imitimit
- B) Është një mjet që funksionon menjëherë
- C) Nuk mund të përdoret ndaj sjelljeve problematike serioze

që duhen kontrolluar menjëherë

D) Mësuesit “harrojnë“ të vënë në dukje dhe të vlerësojnë aktin e imitimit dhe kjo strategji nuk mund të përdoret ndaj sjelljeve problematike serioze që duhen kontrolluar menjëherë

Pyetja 20

Cilat nga lojrat e mëposhtme mund të përdoren për ti mësuar nxënësit si

të sillen në klasë:

- A) Loja “Kapi ata“
- B) Tabelat e mbrekullushme
- C) Zare në një qyp
- D) Të gjitha

Pyetja 21

Shprehitë sociale që kanë ndikim në rezultatet mësimore janë:

- A) Shprehitë e mbijetesës mësimore
- B) Imitimi dhe modelimi
- C) Shprehitë e marrëdhënieve me moshatarët
- D) Shprehitë e mbijetesës mësimore dhe shprehitë e marrëdhënieve me moshatarët

Pyetja 22

Cila nga shprehitë e mëposhtme nuk përfshihet tek shprehitë e mbijetesës

mësimore:

- A) Të bindesh ndaj kërkesave dhe udhëzimeve të mësuesit
- B) Të bëshë gjithçka vetë pa kërkuar ndihmë
- C) Të kërkoresh mendimet dhe sugjerimet e të tjerëve
- D) Të tundësh kokën për të komunikuar se ke kuptuar

Pyetja 23

Shprehitë sociale që mungojnë tek nxënësi mund ti identifikojmë me anë të:

- A) Ushtrimeve specifike
- B) Duke ngritur zërin
- C) Shkallëve të vlerësimit
- D) Kërkuarit ndihmë

Pyetja 24

Tek nxënësit popullorë vëmë re këto shprehi të marrëdhëniet me moshtarët:

- A) Kujdesja për pastërtinë dhe pamjen e jashtme
- B) Identifikimi i interesave të përbashkëta me të tjerët
- C) Prezantimi me anë të emrit
- D) Të gjitha

Pyetja 25

Në përzgjedhjen e shprehive zëvendësuese duhen ndjekur kritere si:

- A) Të shërbejë si alternativë e mirë në krahasim me sjelljen e papërshtatshme
- B) Të krijojë një reputacion pozitiv për nxënësin
- C) Të shërbejë si alternativë e mirë në krahasim me sjelljen e papërshtatshme dhe të krijojë një reputacion pozitiv për nxënësin
- D) Asnjëra

Pyetja 26

Tek metodat informale për të përvetësuar shprehitë sociale përfshihen:

- A) Programe për të ndëshkuar sjelljet e papërshtatshme
- B) Mësimi i shprehive sociale në mjedise të ndryshme
- C) Përzgjedhja e shprehive që do të përvetësojnë nga vetë nxënësit

D) Mësimi i shprehive sociale në mjedise të ndryshme dhe përzgjedhja e shprehive që do të përvetësojnë nga vetë nxënësit

Pyetja 27

Mënyrat sesi të mësojnë nxënësit sistematikisht shprehite sociale janë:

- A) Përzgjedhja e dy ose tre shkoë klase si modele për të demonstruar shprehitë sociale
- B) Diskutimi rreth sjelljes në klasë të mos përfshihet në orën e mësimi
- C) Mos-përfshirja e tyre në përzgjedhjen e shprehive që do të diskutohen
- D) Asnjëra

Pyetje 28

Strategjitë e mësimdhënies dhe materialet duhen të zgjidhen në mënyrë

të tillë që:

- A) Të përshtaten me objektivat e mësimi
- B) Të përshtaten me stilin e të nxëni
- C) Të përshtaten me objektivat e mësimi dhe me stilin e të nxëni
- D) Të kalojnë nivelet e ndryshme të nxënësve

Pyetja 29

Me stilin kinestetik të të nxëni kuptojmë:

- A) Të nxëni përmes veprimi
- B) Zhvillimin e aktiviteve konkrete
- C) Inkurajimin e kreativiteti
- D) Të gjitha

Pyetja 30

Përdorimi i tekinkave auditive si kasete, lexime në grup bëjnë

pjesë tek:

- A) Stili primar

- B) Stili auditiv
- C) Stili auditiv dhe vizual
- D) Stili vizual dhe kineestetik

Pyetja 31

Nxënësit e gjinisë mashkullore në stilin e tyre të të nxënit

tentojnë të jenë :

- A) Të stilit vizual
- B) Të stilit kinestetik
- C) Të stilit vizual dhe kinestetik
- D) Të stilit auditiv dhe visual

Pyetja 32

Nëse nxënësi fillon të shfaqë dridhje, tension muskolor,

mungesë të përfshirjes sociale kemi të bëjmë me:

- A) Nivelin e motivimit
- B) Shprehitë e mbijetesës mësimore
- C) Përfshirjes negative
- D) Asnjëra

Pyetja 33

Kartat “Flesh” përdoren në grupe të vogla ose në çifte për të:

- A) Praktikuar përgjigjet e sakta
- B) Motivuar nxënësit e mirë
- C) Ulur nivelin e ankthit
- D) Motivuar nxënësit e mirë dhe për të ulur nivelin e ankthit

Pyetja 34

Në mënyrë që programi për nxënësin si tutorë të jetë i sukseshëm

mësuesit duhet të:

- A) Përzgjedhin materialet e duhura
- B) Të rishikojnë procedurat siaps nevojës
- C) Përforëcojnë nxënësit tutorë
- D) Të gjitha

Pyetja 35

Vetëmenaxhimi i shprehive të të mësuarit është i rëndësishëm sepse:

- A) Nxënësit e kanë të vështirë të mësojnë shprehi të reja
- B) I ndihmon të përdorin njohuritë në situata të ndryshme
- C) Do të përfitojnë nga të mësuarit në grup
- D) I ndihmon nxënësit të përdorin njohuritë në situata të ndryshme dhe të përfitojnë nga të mësuarit në grup

Pyetja 36

Tek strategjitë e mësimdhënies mund të përfshihen:

- A) Bërja e komenteve negative në vend të atyre pozitive
- B) Koncepte bazë duhen prezantuar në fund në mënyrë që të rrisim të kuptuarin
- C) Ofrimi i udhëzimeve shume të qarta lidhur me çfarë pritet prej tyre nga detyrat e shtëpisë
- D) Të anashkalohen eksperiencat e mëparshme të nxënësve

Pyetja 37

Përfshirja e prindërve në edukim i ndihmon të kuptojnë më

mirë se çfarë:

- A) Rrugësh duhet të ndjekin për të mbështetur fëmijët në shkollë
- B) Shprehishë duhen për të edukuar fëmijët
- C) Informacionet që ndikojnë në jetën e tyre
- D) Të gjitha

Pyetja 38

Tek roli i prindërit si vëzhgues, mësuesit duhet të kene parasysht qe të:

- A) Organizojnë mbledhje duke vendosur një plan të alternuar për orarin
- B) Marrin pjesë në planifikimin dhe njoftimin e veprimtarive të shkollës
- C) Organizojnë mbledhje duke vendosur një plan të alternuar për orarin dhe te marrin pjesë në planifikimin dhe njoftimin e veprimtarive të shkollës
- D) Asnjëra

Pyetja 39

Hartimi i një plan të mirë për zhvillimin e partneritetit

shkollë – familje kërkon:

- A) Mësimin sesi e kuptojnë anëtarët e bordit të prindërve dhe vetë stafi i shkollës përfshirjen e prindërit në edukim
- B) Rishikimin e programit të këtij partneriteti
- C) Vlerësimin e performancës së nxënësve
- D) Inkurajimin e sjelleve pozitive te fëmijët

Pyetja 40

Roli i prindërit si mbështetës për fëmijën dhe shkollën ka

të bëjë me:

- A) Përforcimin e rolit të tij si prindër në krahasim me shkollën
- B) Krijimin e kushteve për zhvillim të mirë fizik dhe emocional të fëmijës
- C) Ndjekjen e të gjitha veprimtarive të shkollës
- D) Krijimin e kushteve për zhvillim të mirë fizik dhe emocional të fëmijës dhe ndjekjen e të gjitha veprimtarive të shkollës

Pyetja 41

Efektet negative të përfshirjes së prindërve/kujdestarët me detyrat e shtëpisë janë:

- A) Inkurajonë nxënësit të mësojnë edhe jashtë klasës
- B) Ulë sasinë e punës për mësuesit
- C) Rritë diferencat mes nxënësve të mirë dhe jo të mirë
- D) Asnjëra

Pyetja 42

Në cilin nga komponentët analitikë duhen të fokusohen mësuesit, për të vlerësuar shkaqet e një sjellje jo të mirë:

- A) motivimi në klasë
- B) sjella dhe percipituesit
- C) ankthi dhe pasojat
- D) familja e nxënësit

Pyetja 43

Kur një nxënësi që nuk është mirë në matematikë, i jepet kjo detyrë, ai mund të përgjigjet me:

- A) Agresion
- B) Ankesa për dhimbje barku
- C) Qëndrimin me shokët
- D) Agresion dhe ankesa për dhimbje barku

Pyetja 44

Disa nga ndërhyrjet e mësuesit tek nxënësit që kryejnë sjellje të përsëritura që kanë efekt vetëpërforsues janë:

- A) Të ndërpres sjelljen e nxënësit

- B) Përdorimi i dënimeve ose gjobave
- C) Dhënia e përforcuesve pozitivë për të shmangur sjelljen
- D) I kushton më shumë vëmendje nxënësit

Pyetja 44

Qëllimi që i shërben sjellja agresive tek nxënësi është:

- A) Për të humbur diçka
- B) Për të ulur nivelin e kërkesave
- C) Për të fituar prestigj
- D) Asnjëra

Pyetja 45

Tregimi me gisht ose shikimi i fiksuar tek nxënësi, janë shembuj të:

- A) Përshkallëzimit të agresionit
- B) Evetimit të përplasjes për pushtet
- C) Rregullave të shkollës për raste emergjente
- D) Qetësimin të situatës

Pyetja 46

Teknika ndëshkuese e kohës bosh funksionon vetëm nëse

mjedisi ku vendoset nxënësi nuk është:

- A) Ndëshkues
- B) Përforcues
- C) Kërkues
- D) I këndshëm

Pyetja 47

Në mënyrë që të jenë sa më efektive procedurat ndëshkuese

ndaj sjelljeve problematike, mësuesi duhet që t'i:

- A) Qëndrojnë vetëm tek procedurat ndëshkuese
- B) Përdori në mënyrë graduale
- C) Kombinojnë me situata jo përforcuese
- D) Përdori në mënyrë graduale dhe t'i kombinojnë me situata jo përforcuese

Pyetja 48

Tek ndërhyrjet për të rritur ndershmërinë dhe pakësuar gënjeshtat

e nxënësit përfshihen:

- A) Përdorimi i përforcuesit me korenspondimet mes asaj se çfare thotë ose premtion dhe asaj që bën
- B) Diskutimi ne klasë me temën pse është e rëndësishme të thuash të vërtetën dhe të mos gënjesht
- C) Përdorimi i përforcuesit me korenspondimet mes asaj se çfare thotë ose premtion dhe asaj që bën dhe diskutimi ne klasë me temën pse është e rëndësishme të thuash të vërtetën dhe të mos gënjesht
- D) Asnjëra

Pyetja 49

Roli i mësuesit në parandalimin dhe uljen e abuzimit me drogat dhe

alkoolin konsiston në:

- A) Ndërgjegjësimin për shenjat, treguesit dhe efektet e përdorimit të drogave dhe alkoolit
- B) Zhvillimi i programeve për edukimin e nxënësit
- C) Krijimi i një sistemi referimi për nxënësit dhe familjet e tyre
- D) Të gjitha

Pyetja 50

Cilat nga sferat e mëposhtme është prekur, kur nxënësi shfaq sjellje të tilla si:
mungesë përgjegjësie, sjelle të çuditshme pa asnje shkak, ankth të vazhdushëm, etj.

- A) Sfera emocionale/ mendore
- B) Sfera sociale
- C) Sfera fizike
- D) Asnjëra

PROGRAMI I PËRBASHKËT PEDAGOGJI

PJESA E GJASHTË

PSIKOLOGJI ZHVILLIMI

Pyetja 1

Psikologjia e zhvillimit studion:

- A)Ndryshimet që ndodhin natyrshëm në lidhje me moshën , në trup, në të menduar, në emocione, në sjellje, në marrëdhënie dhe në role gjatë gjithë hapësirës jetësore
- B)Ndryshimet që ndodhin në mënyrë jo të natyrshme në lidhje me moshën, në trup, në të menduar, në emocione, në sjellje, në marrëdhënie dhe në role gjatë gjithë hapësirës jetësore
- C)Ndryshimet që ndodhin natyrshëm në lidhje me moshën , në trup, në të menduar, në emocione, në sjellje, në marrëdhënie dhe në role nga fëmijëria deri në adoleshencë
- D)Ndryshimet që ndodhin natyrshëm në lidhje me moshën , në trup, në të menduar, në emocione, në sjellje, në marrëdhënie dhe në role gjatë adoleshencës

Pyetja 2

Psikologjia e zhvillimit synon të përshkruajë ndryshimet që ndodhin gjatë gjithë hapësirës jetësore në mënyrë që:

- A)Të japë një pamje të detajuar të zhvillimit për një moshë të caktuar
- B)Të japë një pamje vetëm të proceseve biologjike që ndikojnë zhvillimin
- C)Të shpjegojë më mirë procesin e plakjes

D)Të japë një pamje të përgjithshme të zhvillimit

Pyetja 3

Parashikimi i ndryshimeve që mund të ndodhin ndihmon që:

- A)Të parandalohen sjelljet që mund të ndodhin në të ardhmen
- B)Të kontrollohen sjelljet e ardhshme, të trajtohen problemet dhe të përmirësohet jeta e individëve
- C)Të përshpejtohet zhvillimi i individit
- D)Të ngadalësohet zhvillimi i individit

Pyetja 4

Të gjitha janë synim i psikologjisë së zhvillimit, me përjashtim të :

- A)Krahasimit
- B)Influencimit
- C)Përshpejtimit
- D)Përshkrimit

Pyetja 5

Zhvillimi është një proces që përfshin:

- A)Zhvillimin biologjik dhe social
- B)Zhvillimin fizik dhe kognitiv
- C)Zhvillimin emocional dhe të personalitetit
- D)zhvillimin biologjik, fizik, kognitiv, social, emocional dhe të personalitetit.

Pyetja 6

Studimi i zhvillimit biologjik, fizik, kognitiv, social, emocional dhe të personalitetit tregon se zhvillimi është :

- A)I organizuar
- B)Shumëdimensional
- C)I vazhdueshëm
- D)I diferencuar

Pyetja 7

Zhvillimi është holistik (tërësor), do të thotë se :

- A)Ndryshimet ndodhin të izoluara
- B)Zhvillimi studion anët më të komplikuar të individit
- C)Ndryshimet nuk ndodhin kurrë të izoluara
- D)Zhvillimi ndikohet nga mjedisi

Pyetja 8

Zhvillimi është i organizuar do të thotë se :

- A)Shprehitë e ndryshme fillojnë të integrohen
- B)Ne nuk ndryshojmë më pasi kemi arritur një stad të caktuar të pjekurisë
- C)Zhvillimi reflekton më së shumti vazhdimësi se mosvazhdimësi
- D)Zhvillimi reflekton stabilitet

Pyetja 9

Zhvillimi është relativ do të thotë se:

- A)Ne nuk ndryshojmë më pasi kemi arritur një stad të caktuar të pjekurisë
- B)Ne vazhdojmë përsëri të ndryshojmë edhe kur kemi arritur një stad të caktuar të pjekurisë.
- C)Ne ndryshojmë në varësi të ndryshimeve që ndodhin në mjedis
- D)Zhvillimi është një proces i komplikuar

Pyetja 10

Mesatarja e zhvillimit pasqyron :

- A)Diferencat e shumta individuale në zhvillim.
- B)Peshën dhe gjatësinë mesatare për një moshë të caktuar
- C)Aftësitë intelektuale për një moshë të caktuar.
- D)Peshën, gjatësinë mesatare , fjalorin mesatar për një moshë të caktuar.

Pyetja 11

Meqënëse jo të gjitha dimensionet e personalitetit zhvillohen në të njëjtin nivel dhe ritëm atëherë zhvillimi është :

- A) Individual
- B) Kompleks
- C) Variabël
- D) Akumulativ

Pyetja 12

Rritja, maturimi dhe të mësuarit janë procese që e bëjnë zhvillimin :

- A) Të varuar nga përbërja gjenetike e individit
- B) Të pavarur nga përbërja gjenetike e individit
- C) Një proces të thjeshtë
- D) Një proces kompleks

Pyetja 13

Sipas psikologjisë së zhvillimit, mosha e rritur e hershme përfshin periudhën :

- A) 12-21 vjeç
- B) 18-40 vjeç
- C) 18-30 vjeç
- D) 21-45 vjeç

Pyetja 14

Mosha e rritur e vonë është periudha kur njeriu:

- A) Përshtatet me rënien e forcave, rënien mendore dhe të shëndetit.
- B) Përrjeton krizën e mesit të jetës.
- C) Përshtatet me disa ndryshime fizike, emocionale.
- D) Arrin kulmin e përgjegjësive sociale.

Pyetja 15

Fëmijëria e hershme përfshin periudhën nga :

- A)0-2 vjeç
- B)0-6 vjeç
- C)2-6 vjeç
- D)3-6 vjeç

Pyetja 16

Detyrat kryesore të moshës së rritur të hershme janë :

- A)Zhvillimi i identitetit, të menduarit abstrakt dhe logjik.
- B) Zgjedhja e partnerit, profesioni, pavarësia ekonomike.
- C)Përshtatja me ndryshimet fizike, emocionale
- D)Arritja e kulmit të suksesit profesional dhe përballimi i largimit të fëmijëve nga shtëpia.

Pyetja 17

Sipas Frojdit ndërgjegja e njeriut ka disa nivele :

- A) Nivelin e vetëdijshëm dhe nivelin e pavetëdijshëm
- B) Nivelin e paravetëdijshëm dhe nivelin e vetëdijshëm
- C) Nivelin e vetëdijshëm, paravetëdijshëm dhe pavetëdijshëm
- D) Nivelin e paravetëdijshëm dhe nivelin e pavetëdijshëm

Pyetja 18

Niveli i vetëdijshëm i ndërgjegjes njerëzore sipas Frojdit, ka të bëjë me:

- A)Kujtimet që mund të bëhen të vetëdijshme
- B)Ndërgjegjen imediate dhe përfshin një porcion të vogël të mendjes
- C)Atë pjesë të mendjes që është përtej ndërgjegjes imediate
- D)Mekanizmat mbrojtës që përdor individi

Pyetja 19

Sipas teorisë psikoanalitike Ego është :

- A) Pjesa primitive e mendjes që operon sipas parimit të kënaqësisë
- B) Ajo pjesë e mendjes që përfaqëson perfeksionizmin
- C) Ajo pjesë që operon me anë të proceseve sekondare ose proceseve të realitetit.
- D) Ajo pjesë e mendjes që është tërësisht e vetëdijshme

Pyetja 20

Kur superego zhvillohet shumë, sipas psikanalizës:

- A) Njeriu nuk është në gjendje që të kontrollojë sjelljen.
- B) Njeriu është në gjendje që të kontrollojë sjelljen.
- C) Njeriu kthehet në një qenie tërësisht instiktive
- D) Njeriu nuk mund të veprojë mbi bazën e parimit të moralitetit.

Pyetja 21

Mozhvillimi i një egoje të fortë vjen si pasojë e :

- A) Mjedisit
- B) Gjenetikës
- C) Mosruajtjes së balancave midis idit, egos, superegos
- D) Ndëshkimeve prindërore

Pyetja 22

Mozhvillimi i një egoje të fortë shpie në :

- A) Sjellje të papërshtatshme, ndjenja faji, turpi
- B) Mungesën e ndjeve të fajit, turpit
- C) Përjetimin më të shpeshtë të krizave gjatë zhvillimit
- D) Rritjen e kontrollit moral mbi sjelljen

Pyetja 23

Mekanizmat mbrojtës janë :

- A)Procese të vetëdijshme që shërbejnë për të çliruar ankthin
- B)Procese që nuk kanë lidhje me ndjenjën e ankthit
- C)Procese që ndihmojnë zhvillimin
- D)Procese automatike, të pavetëdijshme që shërbejnë për të çliruar ankthin

Pyetja 24

Introjksioni është mekanizmi mbrojtës nëpërmjet të cilit :

- A)Mendime, tipare të tua ua mvesh të tjerëve
- B)Adapton standartet dhe vlerat e dikujt tjetër që keni frikë ta kundërshtoni
- C)Kundërshton ndjenjat e papranueshme
- D) Mohon situatën aktuale

Pyetja 25

Fiksacionet sipas Frojdit janë :

- A)Ndalesa në zhvillim, të cilat bëjnë që një individ të kërkojë kënaqësi përmes mënyrave të përshtatshme për fëmijët
- B)Probleme që ndodhin kur zonat erogjene stimulohen mesatarisht
- C)Probleme që shfaqen kur individi fiksohet në stadin e latencës
- D) Ndryshime në sjellje që nuk ndikojnë zhvillimin

Pyetja 26

Kompleksi i Edipit dhe i Elektrës shfaqen në stadin:

- A)Oral
- B)Anal
- C)Fallik
- D)Latent

Pyetja 27

Sipas psikanalizës gjatë stadit të latencës:

- A) Rizgohet në mënyrë të pavetëdijshme dëshira seksuale
- B) Djemtë përjetojnë zilinë e penisit
- C) Libido vendoset në kavitetin anal
- D) Dëshira seksuale bëhet e fjetur

Pyetja 28

Një ndër kritikant kryesore ndaj teorisë psikanalitike është që:

- A) Vë theksin në përvojat e kaluara dhe mbivlerëson rolin e instiktit seksual
- B) Vuri theksin për herë të parë tek mendja e pavetëdijshme
- C) Nuk e vlerëson sa duhet rolin e instiktit seksual
- D) Mbivlerësimi i mekanizmave mbrojtës

Pyetja 29

Principi epigjenetik nënkupton :

- A) Personaliteti nuk zhvillohet duke u bazuar në ndonjë plan të paravendosur
- B) Personaliteti zhvillohet në bazë të disa fazave të paracaktuara, të organizuara biologjikisht
- C) Qëniet njerëzorë nuk janë të organizuara biologjikisht
- D) Mjedisi është faktori kryesor që ndikon zhvillimin

Pyetja 30

Rregullsia dhe parashikueshmëria e mjedisit janë dy kushtet kryesore që duhet të plotësojë mjedisi, në mënyrë që fëmija të fitojë:

- A) Besimin
- B) Autonominë
- C) Iniciativën
- D) Zëllin për punë

Pyetja 31

Iniciativë kundrejt ndjenjës së fajit, është një stad që sipas Eriksonit përfshin moshën :

- A)0-2 vjeç
- B)3-5 vjeç
- C)1vjeç e gjysëm -3 vjeç
- D)5-12 vjeç

Pyetja 32

Sipas Eriksonit individi mund të zhvillojë një sens izolimi në qoftë se nuk zgjidh siç duhet konfliktin e moshës:

- A)12-18 vjeç
- B)35-65 vjeç
- C)18-35 vjeç
- D)65 vjeç e lart

Pyetja 33

Vlera kryesore e teorisë së Eriksonit është :

- A) Mund të provohet eksperimentalisht
- B) Nuk bazohet në interpretime subjektive
- C) Zhvillimi mbaron në adoleshencë
- D) Thekson rëndësinë e socializimit dhe e zgjeron zhvillimin gjatë gjithë jetës

Pyetja 34

Fitimi i informacionit të ri duke përdorur strukturat mendore ekzistuese realizohet nëpërmjet procesit të :

- A)Asimilimit
- B)Adaptimit
- C)Organizimit
- D)Mohimit

Pyetja 35

Sipas Piazhesë Ekuilibri është :

- A) Përdorimi me kriter i mekanizmave mbrojtës
- B) Tendenca që ka njeriu për të sistemuar proceset
- C) Përpjekje për të ruajtur balancën midis asimilimit dhe akomodimit
- D) Kompesimi i një defičiti real ose imagjinar

Pyetja 36

Sipas Piazhesë sistemimi dhe kombinimi i proceseve në sisteme koherente dhe të ndërlidhura logjiksht kryhet përmes :

- A) Ekuilibrit
- B) Racionalizimit
- C) Asimilimit
- D) Organizimit

Pyetja 37

Gjatë stadii sensorimotorik fëmija e njeh objektin :

- A) Duke ia përshkruar prindi
- B) Nëpërmjet gjesteve
- C) Përmes veprimit direkt mbi të
- D) Përmes logjikës

Pyetja 38

Fëmija bëhet i aftë për të menduar sesi gjërat ndryshojnë nga një gjëndje në tjetrën, pra fiton aftësinë e konservimit në stadin e :

- A) Operacioneve formale
- B) Paraoperacional

- C) Sensorimotorik
- D) Operacioneve konkrete

Pyetja 39

Një nga vlerat e teorisë kognitiviste të Piazhës është :

- A) Vë në dukje se fëmija është një qenie aktive
- B) Mbivlerëson ndikimet e të mësuarit
- C) Ka përdorur metodën e vëzhgimit
- D) Të gjithë studjuesit mendojnë se zhvillimi kalon në këto stade

Pyetja 40

Sipas Piazhës fëmija në moshën 5 vjeç është në stadin e:

- A) Sensorimotorik
- B) Paraoperacional
- C) Operacioneve konkrete
- D) Operacioneve formale

Pyetja 41

Sipas Vigotskit zona e zhvillimit proksimal është :

- A) Zona përgjegjëse për zhvillim fizik
- B) Diferenca midis asaj që fëmijët mund të bëjnë vetëm dhe asaj që mund të bëjnë me ndihmën e të tjerëve.
- C) Zona përgjegjëse për zhvillimin kognitiv
- D) Zona ku fëmijët nuk mund të veprojnë pa ndihmën e të tjerëve

Pyetja 42

Teoritë bihejvioriste bazohen në parimin se :

- A) Sjellja nuk mund të studjohet objektivisht
- B) Sjellja mund dhe duhet të studjohet objektivisht
- C) Individu nuk mund të shikohet si makinë

D) Në shumë raste sjelljet nuk janë funksion i përforcimeve apo ndëshkimeve.

Pyetja 43

Termi kushtëzim përdoret për të emërtuar një lloj të mësuarit ku :

- A) Mjedisi nuk ndikon sjelljen
- B) Sjelljet nuk mund të parashikohen
- C) Personaliteti kushtëzon sjelljet
- D) Disa sjellje që ndikohen nga mjedisi bëhen të mundshme dhe të parashikueshme

Pyetja 44

Sipas kushtëzimit klasik, stimuli i pakushtëzuar është :

- A) Stimuli që është fillimisht neutral, por bëhet efektiv më pas
- B) Stimuli që shkakton reagimin e kushtëzuar
- C) Stimuli që shkakton një reagim automatik
- D) Një stimul i panevojshëm që edhe mund të hiqet

Pyetja 45

Gjatë stadi të kushtëzimit:

- A) Një stimul i pakushtëzuar shkakton një reagim të pakushtëzuar
- B) Stimuli i pakushtëzuar shoqërohet me stimulimin e kushtëzuar
- C) Paraqitet vetëm stimuli i kushtëzuar
- D) Reagimi i pakushtëzuar ndodh vetëm në prani të stimullit të kushtëzuar

Pyetja 46

Në kushtëzimin klasik stadi i pas kushtëzimit vjen menjëherë pas:

- A) Stadi të parakushtëzimit
- B) Stadi të kushtëzimit
- C) Veprimi të stimullit të pakushtëzuar

D)Reagimit të pakushtëzuar

Pyetja 47

Sapo një person apo kafshë të ketë mësuar të reagojë ndaj një stimuli të kushtëzuar atëherë dhe stimujt e tjerë të ngjashëm me të shkaktojnë të njëjtin reagim. Në këtë rast themi se ka ndodhur :

- A)Kushtëzimi operant
- B)Organizimi
- C)Gjeneralizimi i stimulit
- D)Shoqërimi i stimujve

Pyetja 48

Në kushtëzimin e rendit më të lartë:

- A)Shoqërimi i stimulit të kushtëzuar me stimul neutral bën që stimuli neutral të shkaktojë të njëjtin efekt si stimuli i kushtëzuar
- B)Asnjë stimul neutral nuk mund të shkaktojë efektin e stimulit të kushtëzuar
- C)Është e vështirë të kuptosh rolin e stimulit neutral
- D)Nuk ka rëndësi shoqërimi në kohë i stimujve

Pyetja 49

Nëse dikush mëson të reagojë me frikë ndaj një stimuli kur sheh dikë tjetër që është duke reaguar me frikë ndaj këtij stimuli,kjo dukuri njihet me emrin :

- A)Kushtëzim klasik
- B)Kushtëzim operant
- C)Stimul i pakushtëzuar
- D)Kushtëzim imagjnativ

Pyetja 50

Në kushtëzimin operant :

- A)Individi bën diçka në mjedis dhe ndërkohë diçka ndodh ndaj tij
- B)Individi operon në mjedisin e tij por ndaj tij nuk ndodh asgjë
- C)Nuk ka asnjë lidhje midis individit dhe mjedisit
- D)Vepron vetëm mjedisi

Pyetja 51

Në themel të kushtëzimit operant qëndron parimi :

- A)Që një sjellje të përsëritet nuk ka asnjë rëndësi stimuli
- B)Sjellja që pasohet nga një stimul pozitiv ka të ngjarë të ndodhë prapë, ndërsa sjellja që pasohet nga një stimul negativ ka të ngjarë të mos përsëritet
- C)Sjellja që ndëshkohet ka prirjen të përsëritet
- D)Një përfrocues nuk është e njëjta gjë si një stimul

Pyetja 52

Përforcim pozitiv quhet kur:

- A)Diçka e pakëndshme i hiqet dikujt
- B)Diçka e këndshme i hiqet dikujt
- C)Diçka e pakëndshme i jepet dikujt
- D)Diçka e këndshme i jepet dikujt

Pyetja 53

Kur individi ose kafsha përforcohet pasi të ketë kryer një numër të caktuar reagimesh, kemi të bëjmë me :

- A)Kushtëzim klasik
- B)Përforcim me raporte të fiksuara
- C)Përforcim me raporte të ndryshueshme
- D)Përforcim me intervale të ndryshueshme kohore

Pyetja 54

Në jetën reale sjelljet nuk përforcohen në mënyrë të vazhdueshme, atëhere themi se përforcohen në mënyrë :

- A) Të pjesshme
- B) Të fiksuar
- C) Të ndryshueshme
- D) Të thjeshtë

Pyetja 55

Në përforcimin me raporte të ndryshueshme :

- A) Individit e di se kur do të përforcohet
- B) Individit nuk e di se kur do të përforcohet
- C) Individit përforcohet pas një numri të caktuar reagimesh
- D) Individit ndëshkohet

Pyetja 56

Një nga dallimet midis kushtëzimit klasik dhe kushtëzimit operant është se :

- A) Në kushtëzimin klasik individit ose kafsha është aktiv, ndërsa në kushtëzimin operant individit ose kafsha është pasiv
- B) Në kushtëzimin operant nuk kanë rëndësi pasojat
- C) Në kushtëzimin klasik individit ose kafsha është pasiv, ndërsa në kushtëzimin operant individit ose kafsha është aktiv
- D) Në kushtëzimin operant reagimet nuk shoqërohen me asnjë pasojë

Pyetja 57

Teoria sociale të mësuarit e Bandurës mund të përmblihet :

- A) Imitimi nuk përforcohet
- B) Sjelljet formohen përmes vëzhgimit të sjelljeve të tjerëve dhe imitimi përforcohet
- C) Sjelljet nuk formohen përmes vëzhgimit të sjelljeve të tjerëve

D)Të gjitha reagimet janë të lindura

Pyetja 58

Një nga efektet e imitimit në sjellje është efekti nxitës. Kjo do të thotë se :

- A)Sjellja që përvetësohet është identike me sjelljen e modelit
- B)Sjellja që përvetësohet nuk ka asnjë lidhje me sjelljen e modelit
- C)Sjellja që përvetësohet nuk është identike me sjelljen e modelit por thjesht e lidhur me të
- D)Sjellja që përvetësohet është gjithmonë negative

Pyetja 59

Besimet e individit lidhur me efikasitetin vetjak përcaktohen nga :

- A)Efektet e krahasimeve që i bëjmë vetes në lidhje me të tjerët dhe efektet direkte të sjelljes sonë
- B)Efektet indirekte të sjelljes tonë
- C)Mekanizmi mbrojtës i mohimit
- D)Reagimet e mësuesve

Pyetja 60

Një nga anët pozitive të teorive bihejvioriste është që :

- A)I kushtojnë rëndësinë e duhur proceseve të larta mendore
- B)Janë kronologjike
- C)Nuk kanë një natyrë rigoroze shkencore
- D)Na bëjnë të vetëdijshëm për rëndësinë që ka përshtatja ndaj rrethanave të ndryshueshme mjedisore

Pyetja 61

Një nga dobësitë e teorive bihejvioriste është që :

- A) Janë teori që e thjeshtëzojnë zhvillimin
- B) Kanë një natyrë rigorozë shkencore
- C) Theksojnë rëndësinë e rolit të mjedisit
- D) Nuk janë teori mekanistike

Pyetja 62

Periudha më e frytshme e punës profesionale dhe kreative, sipas Sharlota Bahler përkon me fazën e :

- A) Parë të zhvillimit
- B) Dytë të zhvillimit
- C) Tretë të zhvillimit
- D) Katërt të zhvillimit

Pyetja 63

Në hierarkinë e nevojave të Maslou, nevoja për vlerësim vjen menjëherë pas nevojës për :

- A) Siguri
- B) Dashuri dhe përkatësi
- C) Nevojave fiziologjike
- D) Vetëaktualizimit

Pyetja 64

Terapia e fokusuar tek klienti e Karl Rogers :

- A) Është e njëjtë me psikanalizën
- B) Bazohet tek kritikën
- C) Bazohet tek mbështetja emocionale, mjedisi pranues dhe inkurajimi
- D) Është terapi bihejvioriste

Pyetja 65

Qëndrimi pozitiv i pakushtëzuar është :

- A) Kur individi konformohet me standartet prindërore dhe sociale
- B) Kur individi ndëshkohet nëse nuk përmbush standartet e të tjerëve
- C) Kur shoqëria merr përsipër të zgjidhë problemet e individit
- D) Aprovim dhe vlerësim për individin pavarësisht nga sjellja e tij

Pyetja 66

Periudha sensitive është një koncept i :

- A)Psikanalizës
- B)Etiologjisë
- C)Kognitivizmit
- D)Bihejviorizmit

Pyetja 67

Teoritë Etiologjike janë teori që theksojnë:

- A)Rolin e pavetëdijës në zhvillimin human
- B)Rolin e përforcimeve dhe ndëshkimeve në zhvillim
- C)Rolin e evolucionit dhe biologjisë në zhvillim
- D)Rolin e mekanizmave mbrojtës në zhvillim

Pyetja 68

Sindroma Daun është :

- A)Rasti kur kombinimi kromozomik është Xo
- B)Rasti kur kombinimi kromozomik femëror përmban kromosome X më tepër se normalja
- C)Dëmtimi i pjesës së fundit të kromosomit X
- D)Rasti kur çifti i 21-të i kromosomeve ka një kromosom shtesë.

Pyetja 69

Futja e një shiringe të hollë në barkun e nënës për të marrë lëngun amniotik gjatë javës së 12-të dhe të 14-të të shtatzanisë, quhet:

- A) Sonografi ultrasonike
- B) Amniocenteza
- C) Testi i villit korionik
- D) Fetoskopia

Pyetja 70

Tërësia e instruksioneve gjenetike quhet:

- A) Fenotip
- B) Trashëgimi
- C) Gjenotip
- D) Alele

Pyetja 71

Periudha e embrionit zgjat nga :

- A) Java e dytë e konceptimit deri në javën e tetë pas konceptimit
- B) Konceptimi deri në 2 javë
- C) 3-4 ditë pas konceptimit
- D) Konceptimi deri në 4 muaj pas konceptimit

Pyetja 72

Zhvillimi proksimodistal është ai lloj zhvillimi që ndodh :

- A) Nga koka tek këmbët
- B) Nga qendra në periferi të trupit
- C) Vetëm në shtresat e lëkurës
- D) Në përbërjen e lëngut amniotik

Pyetja 73

Një nga organet që zhvillohet më shumë në periudhën e fetusit është :

- A) Zemra
- B) Mëlçia
- C) Truri
- D) Mushkëria

Pyetja 74

Teratogenët janë :

- A) Të gjitha substancat e dëmshme që arrijnë të kapërcejnë murin e placentës dhe të dëmtojnë embrionin ose fetusin
- B) Të gjitha substancat që përdoren për të mbrojtur embrionin ose fetusin
- C) Antibiotikë që mund të përdoren gjatë shtatzanisë
- D) Defekte gjenetike

Pyetja 75

Është provuar se prapambetja brendauterine e rritjes shkaktohet nga :

- A) Alkooli
- B) Duhani
- C) Ilaçet mjekësore
- D) Mosha e babait

Pyetja 76

Vendosja e menjëherëshme e fëmijës në gjoksin ose barkun e nënës është praktikë e metodës:

- A) Kisinger
- B) Lamazë
- C) Laboyer
- D) Cezariane

Pyetja 77

Fëmija kalon rreth 1/3 e ditës në gjëndjen e :

- A) Gjumin të rregullt
- B) Përgjumes
- C) Të qarave
- D) Gjumin të parregullt

Pyetja 78

Nëse ledhatori shputën e këmbës së të sapolindurit në drejtim nga thembra drejt gishtave, gishtat hapen dhe këmba kthehet përbrenda. Në këtë rast kemi të bëjmë me :

- A) Refleksin moro
- B) Refleksin e kapjes
- C) Refleksin babinski
- D) Refleksin pupilar

Pyetja 79

I sapolinduri :

- A) Është i aftë të familjarizohet dhe të mërzhitet ndaj tingujve të përsëritur
- B) Nuk është i aftë të dallojë mes një tingulli të fortë dhe të dobët
- C) Është i aftë të shikojë objekte që ndodhen më larg se 25 cm larg syve
- D) Nuk qetësohet prej tingujve ritmikë

Pyetja 80

Sindroma e vdekjes së papritur feminare ndodh:

- A) rreth moshës 2 vjeç
- B) gjatë javës së parë pas lindjes
- C) nga 3 javë deri në 1 vit
- D) gjatë shatzanisë

Pyetja 81

Dy shprehitë madhore motorike që zhvillohen në fëmijëri janë :

- A) Rregullimi i temperaturës dhe tretja

- B) Perceptimi i fytyrës dhe i thellësisë
- C) Rregullia e gjumit dhe përshtatshmëria
- D) Kapja dhe lëvizja e objekteve nga një vend në tjetrin

Pyetja 82

Frika shfaqet tek fëmijët në moshën :

- A) 4 muajsh
- B) 8 muajsh
- C) 2 vjeç
- D) 2 muajsh

Pyetja 83

Reagimet cirkulare parësore janë:

- A) Ato reagime që fëmija i kryen më parë me trupin e vet, sesa me objekte në mjedisin përreth
- B) Ato reagime që fëmija i kryen duke u fokusuar mbi objektet dhe ngjarjet përreth
- C) Ato reagime kur fëmija përdor rrugë të reja për arritjen e qëllimeve
- D) Ato reagime kur fëmija mendon për objektet përmes formimit të pikturave mendore

Pyetja 84

Aftësia për të përfaqësuar së brëndshmi ngjarje që nuk janë duke vepruar aktualisht në shqisën e fëmijës quhet :

- A) Vazhdimësi e objektit
- B) Projekcion
- C) Të menduarit simbolik
- D) Konservim

Pyetja 85

Shpikja e mënyrave të reja për të arritur qëllimet përmes eksplorimit dhe eksperimentimit aktiv quhet:

- A) Reagim cirkular parësor
- B) Reagim cirkular dytësor
- C) Reagim cirkular tretësor
- D) Reagim cirkular i thjeshtë

Pyetja 86

Foshnjat e vështira karakterizohen nga:

- A) Niveli i ulët i aktivitetit
- B) Reagime në mënyrë intensive
- C) Afrueshmëria ndaj njerëzve të panjohur
- D) Rregullsia në fjetje

Pyetja 87

Foshnjat e ngadalta dhe foshnjat e lehta kanë karakteristikë të përbashkët :

- A) Afrueshmërinë ndaj njerëzve të panjohur
- B) Përshtatjen me lehtësi ndaj ndryshimeve
- C) Irritueshmërinë
- D) Reagimet me intensitet të ulët

Pyetja 88

Atashimi tek foshnjat shfaqet :

- A) Në muajin e parë
- B) Në muajin e 9-të deri në muajin e 12-të
- C) Në muajin e tretë të jetës
- D) Në muajin e 12-të deri në muajin e 18-të

Pyetja 89

Foshnjat shfaqin elemente të zhgënjimit dhe frustracionit në stadin :

- A) e parë të zhvillimit emocional
- B) e dytë të zhvillimit emocional
- C) e tretë të zhvillimit emocional
- D) e katërt të zhvillimit emocional

Pyetja 90

Sipas Bowlby, foshnja gjatë fazës së para atashimit është:

- A) në gjendje të dallojë konceptin e vazhdimësisë së objektit
- B) i buzëqesh dhe i vokalizon kujdestarit primar
- C) i paintersuar për asnjeri në dukje
- D) duke përjetuar ankthin e ndarjes

Pyetja 91

Foshnja përjeton ankth ndaj njerëzve të panjohur gjatë fazës:

- A) para atashimit
- B) atashimit në formim e sipër
- C) atashimit të fiksuar
- D) atashimit me modifikimin e synimit

Pyetja 92

Foshnjat e atashuar në mënyrë të pasigurt të tipit rezistent (Tipi C) sipas Mari Einsuorth janë foshnje :

- A) Të cilat qetësohen në praninë e prindërve
- B) Nuk qetësohen edhe kur kanë prindërit pranë
- C) I injorojnë fare prindërit kur kthehen
- D) E kanë të lehtë të përdorin prindërit si bazë sigurie

Pyetja 93

Nga studimet për vetëdijen, konstatohet se foshnjat zhvillojnë konceptin për veten, rreth moshës:

- A) 1 muajsh
- B) 2 muajsh
- C) 16 muajsh
- D) 18 muajsh

Pyetja 94

Loja simbolike është :

- A) Loja gjatë së cilës fëmija është indiferent
- B) Loja kur fëmija ka një imazh mendor të asaj që ka parë dikur por që tani nuk është e pranishme
- C) Një aktivitet në të cilin përdoren simbolet për të përfaqësuar realitetin
- D) Loja gjatë së cilës duket sikur fëmija dialogon me veten

Pyetja 95

Fokusimi vetëm në një aspekt të një objekti ose situatë dhe përjashtimi i aspekteve të tjera quhet :

- A)Centracion
- B)Konservim i volumit
- C)Konservim i masës
- D)Egocentrizëm

Pyetja 96

Mendimi se çdo gjë është krijuar nga njerëzit quhet:

- A)Realizëm
- B)Animizëm
- C)Artificializëm
- D)Arsyetim sinkretik

Pyetja 97

Të nxjerrësh një konkluzion për diçka të veçantë, duke u bazuar në një diçka tjetër të veçantë, do të thotë :

- A) Arsyetim sinkretik
- B) Arsyetim transduktiv
- C) Artificializim
- D) Animizëm

Pyetja 98

Të folurit telegrafik shfaqet në moshën :

- A) 1 vjeç
- B) 2 vjeç
- C) 18 muajsh
- D) 4 vjeç

Pyetja 99

Holofraza është :

- A) fjala e parë që shoqërohet me gjeste dhe përcjell kuptimin e fjalisë
- B) njësia bazë tingullore e gjuhës
- C) kombinimi i dy ose më shumë tingujve
- D) fjali me kuptime të ndryshme

Pyetja 100

Fëmijët bëhen të vetëdijshëm për gjininë në moshën :

- A) 1 vjeç
- B) 18 muajsh
- C) 2-3 vjeç
- D) 5 vjeç